# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5471
E mërkurë, 9 maj 2018
çmimi 0.40 €


## Policia fillon patrullimet me skuterë



FAQE 7


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", DHURATA HOXHA FAQE 4-5

# Integrimi në BE, rruga e vetme e Kosovës

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se integrimi i plotë në Bashkimin Evropian është rruga e vetme e shtetit të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ajo ka deklaruar se institucionet janë duke punuar maksimalisht që Kosova të jetë sa më afër familjes evropiane. Ministrja Hoxha ka bërë me dije se pret vlerësim pozitiv nga Brukseli, duke shprehur optimizëm se brenda këtij viti qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në vendet e Evropës. Ajo ka thënë se procesi integrues euroatlantik ka qenë dhe mbetet prioritet kombëtar i Republikës së Kosovës. Ministrja Hoxha ka vlerësuar se çështjet që kanë të bëjnë me procesin integrues deri më tani kanë dëshmuar unitet të lartë në Qeveri, në Kuvend si dhe në nivelet e tjera të institucioneve qendrore e lokale

ËSHTË MBAJTUR TRYEZA E DYTË E PARTIVE POLITIKE

## Liderët thonë se janë në rrugë të mirë për konsensus kombëtar



Liderët e partive politike kanë bërë me dije se janë në rrugë të mirë për të arritur një konsensus kombëtar për temat e mëdha. Pas tryezës së dytë të partive politike të organizuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ata kanë thënë se konsensusi për këto tema është i domosdoshëm. Këtë herë partitë janë pajtuar të ketë një grup pune të përbërë nga shefat e grupeve të partive parlamentare, i cili do ta caktojë temën konkrete për të cilën do të diskutohet në tryezën e radhës. Në tryezën e thirrur nga PDK-ja nuk kanë marrë pjesë Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe FAQE 3

Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

## KMShK-ja kundërshton iniciativën rreth hartimit të Ligjit për media

Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) ka shprehur shqetësimin dhe kundërshtimin për iniciativën rreth hartimit të Ligjit për media, duke e konsideruar si një përpjekje për kontroll dhe censurë mbi mediat FAQE 7

### AKTUALE



PËRSE NJERËZIT VAZHDOJNË TË JENË MOHUES TË DIJEVE SHKENCORE? F. 11

JAKUP KRASNIQI



DINË GRABOVCI, AI QË DHA GJITHÇKA PËR LIRINË E KOSOVËS F. 11

LULËZIM ETEMAJ

POLICI ARMEND TRENA VARROSET ME NDERIME TË LARTA SHTETËRORE F. 2

### EKONOMI

FORMOHET GRUPI PUNUES PËR INSTITUCIONET QË NUK PAGUAJNË TATIM F. 8

SHKARKOHET BORDI I 'IBËR LEPENCIT' F. 9

### KULTURË

BOTOHET NË GJUHËN ANGLEZE LIBRI 'KOSOVA NGA 'NAÇERTANIE' DERI TE PAVARËSIA (1844-2008)' F. 16

### SPORT

BESA BIE NGA SUPERLIGA, POR ZBULOHET NJË YLL FUTBOLLI F. 18

KOSOVA SOT NISET DREJT SERBISË PËR EVROPIANIN E KARATESË F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666


Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

# Thaçi takon kancelaren Merkel, i kërkon mbështetje për dialogun

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në takimin me kancelarin gjermane Angela Merkel pritet të bisedojë për avancimin e marrëdhënieve bilaterale, për perspektivën evropiane dhe dialogun me Serbinë



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka arritur në Berlin. Sot (e mërkurë) me kancelarin gjermane Angela Merkel do të bisedojnë për avancimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve. "Gjermania ka qenë gjithmonë mbështetëse e rrugëtimit tonë drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Me kancelaren Merkel nesër do të bisedojmë për avancimin e marrëdhënieve bilaterale, për perspektivën evropiane dhe dialogun me Serbinë. Roli i saj në këto procese është përcaktues. Kosova do të jetë e përgjegjshme në procesin e reformave dhe implementimin e obligimeve ndërkombëtare", ka shkruar presidenti Thaçi në "Facebook".

Ndërkaq, në njoftimin e Presidencës thuhet se Thaçi do t'i kërkojë kancelares Merkel mbështetje për Kosovën në arenën ndërkombëtare. "Në këtë takim do të bisedohet për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy shteteve, për rritjen e shkëmbimit ekonomik dhe bashkëpunimin në fusha të tjera. Presidenti Thaçi do ta kërkojë mbështetjen e kancelares Merkel për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, dinamizmin e perspektivës evropiane, si dhe vazhdimin e mbështetjes në fazën e fundit të procesit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", thuhet në njoftimin e Presidencës.

Takimi i presidentit Thaçi me kancelaren Merkel ndodh në momentin kur Gjermania pret që Prishtina dhe Beogradi do ta nënshkruajnë marrëveshjen juridikisht obliguese për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. Kjo marrëveshje do të duhej të nënshkruhej në përfundim të dialogut për të cilin Qeveria e Kosovës, në platformën e propozuar, e ka autorizuar presidentin Thaçi, por që për opozitën është e papranueshme.

Presidenti Thaçi pritet të mbajë një ligjëratë në institucionin prestigjioz të politikës së jashtme, duke reflektuar për të ardhmen e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Këshillin Gjerman për Marrëdhënie Ndërkombëtare me seli në Berlin. Ai paraprakisht është takuar me drejtorin e këtij Këshilli si dhe me ambasadorin gjerman Wolfgant Ischinger.

## Bushati: E shkuara, e tashmja dhe e ardhmja, së bashku drejt BE-së

**Tiranë, 8 maj** - Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati ka thënë se për Shqipërinë projekti evropian është në thelb një projekt bashkimi brenda vetes. Bushati foli në konferencën e zhvilluar të martën me delegacionin e BE-së në Shqipëri: "Së bashku drejt Bashkimit Evropian: Njohja e përvojës së shkuar dhe krijimi i partneriteteve për të ardhmen". Konferenca e konceptuar në dy panele: "Njohja e përvojës së shkuar" dhe "Krijimi i partneriteteve për të ardhmen".

Sipas Bushatit, projekti evropian është projekti të cilin shumica dërrmuese e shqiptarëve e shohin si projektin e paqes, sigurisë, mirëqenies, por mbi të gjitha e shohin si projektin e një qeverisje demokratike për ta.

Për kreun e diplomacisë shqiptare projekti evropian përkon jo vetëm me modernizimin dhe transformimin e shoqërisë sonë, por edhe me konsolidimin e identitetit tonë evropian si komb.

Ish-ministrat e shtetit për integrimin dhe ish-ministra integrimi të ftuar në këtë tryezë, si Sokol Nako, Paskal Milo, Ermelinda Meksi, Majlinda Bregu dhe Klajda Gjosha, diskutuan mbi përvojën e tyre në rrugën e integrimit evropian dhe ndanë bindjen se ky proces është i rëndësishëm për të gjithë shqiptarët përtej çdo përkatësie politike.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nisi sot diskutimin me përfaqësues të shoqërisë civile të platformës së partneritetit për anëtarësimin në BE. Ky është një hap i parë në serinë e aktiviteteve të shumta që do të ndërmerren për ta garantuar pjesëmarrjen e qenësishme të të gjithë aktorëve në këtë proces.

MEPJ synon që kjo platformë të garantojë vijimësi, gjithëpërfshirje dhe përgjegjësi përtej binomit qeveri-opozitë.

# Përballë studentëve për vizat

**Prishtinë, 8 maj (ER)** - Në kuadër të shënimit të Ditës së Evropës, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe shefja e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, kanë bashkëbiseduar të martën me studentë, me temën "Çka nënkupton integrimi evropian për të rinjtë e Kosovës".

Ministrja Hoxha theksoi se takimi nuk do të jetë monolog por bashkëbisedim. "Sot kam kënaqësinë të jem në mesin tuaj. Dhe sot do të diskutojmë për sfidat, përgjegjësitë dhe pritjet që i kemi ndaj procesit të integrimit evropian. Sot me ne janë edhe kryetari i Kuvendit, Veseli dhe kryeministri i Kosovës, Haradinaj, dhe përfaqësuesja e BE-së, Apostolova, bartës të përgjegjësive më të larta për të ardhmen evropiane të Kosovës", ka thënë ministrja Hoxha, duke vënë në pah se, megjithëse jemi shumë afër, ne ende nuk gëzojmë të drejtën e lëvizjes së lirë në vendet e BE-së.

Ministrja ka pohuar se brenda këtij viti do ta marrim rekomandimin dhe të fillojë lëvizja e lirë për qytetarët e Kosovës. "Këtu ne t'u bashkohemi shteteve të tjera të rajonit të cilat tash e disa vjet e gëzojnë këtë mundësi", ka thënë Hoxha.

Në fund të këtij bashkëbisedimi, Veseli, Haradinaj, Apostolova dhe Hoxha iu përgjigjen studentëve të cilët parashtruan pyetje që kryesisht fokusoheshin në të drejtën e studimit, lëvizjen e lirë dhe procesin integrues.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Është mbajtur tryeza e dytë e partive politike

# Liderët thonë se janë në rrugë të mirë për konsensus kombëtar

Liderët e partive politike kanë bërë me dije se janë në rrugë të mirë për të arritur një konsensus kombëtar për temat e mëdha. Pas tryezës së dytë të partive politike të organizuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ata kanë thënë se konsensusi për këto tema është i domosdoshëm. Këtë herë partitë janë pajtuar të ketë një grup pune të përbërë nga shefat e grupeve të partive parlamentare, i cili do ta caktojë temën konkrete për të cilën do të diskutohet në tryezën e radhës. Në tryezën e thirrur nga PDK-ja nuk kanë marrë pjesë Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 8 maj** - Udhëheqësit e partive politike kanë shprehur optimizëm për arritjen e konsensusit kombëtar për temat e mëdha. Pas tryezës së dytë të partive politike, këtë herë e organizuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ata kanë thënë se kanë vullnet dhe janë në rrugë të mirë drejt arritjes së këtij qëllimi. Përveç debatit për temat që konsiderohen të rëndësisë kombëtare, përfaqësuesit e partive politike janë pajtuar të ketë një grup pune të përbërë nga shefat e grupeve të partive parlamentare dhe një përfaqësuesi të partive joparlamentare, i cili do të caktojë temën konkrete për të cilën do të diskutohet në tryezën e radhës.

Mikpritësi i këtij takimi, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se tani është bërë hapi i parë i institucionalizimit të tryezës së partive politike. "Sot e bëmë hapin e parë drejt institucionalizimit të tryezës. Që nga takimi i radhës jemi marrë vesh që përfaqësuesit tanë, përkatësisht kryetarët e grupeve parlamentare, do ta marrin rolin e përgatitjes së tryezave të partive politike, domethënë të ftesës, në bazë të radhitjes secila parti e thërret tryezën. Në të njëjtën kohë do të përcaktohen edhe prioritetet. Do të shkojmë tani gradualisht. Hëpërhë i kemi këto pesë temat e para të cilat janë iniciuar nga PDK-ja, kurse në tryezat e ardhshme do të shkojmë temë për temë. Pra, do t'i trajtojmë temat e caktuara qoftë për formimin e ushtrisë së Kosovës, për dialogun me Serbinë, agjendën e reformave evropiane, konsensusin kombëtar për Asociacionin dhe reformën zgjedhore", ka thënë Veseli.

Ai ka treguar se të gjithë pjesëmarrësit e kësaj tryeze kanë treguar gatishmëri për arritjen e konsensusit kombëtar. "Kemi pasur një pjesëmarrje pothuajse absolute të partive politike nga pozita dhe opozita. Na vjen keq për mungesën e Lëvizjes Vetëvendosje dhe të Listës Serbe. Megjithatë, kryesore është se jemi në rrugë të mirë të arritjes së konsensusit kombëtar për temat e mëdha, të cilat në të kaluarën kanë mundur të na humbin kohë. Kosova ka obligime dhe ka nevojë për konsensus. Kosova do ta arrijë suksesin vetëm bashkërisht, pozitë dhe opozitë", ka thënë Veseli, duke shtuar se Kosova shumë shpejt pret liberalizmin e vizave dhe formimin e ushtrisë së Kosovës.

Gatishmëri për një konsensus të tillë ka treguar edhe nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu. "Këto tryeza duhet të vazhdojnë sepse duhet të arrihet konsensus mes subjekteve politike për trajtimin e këtyre temave. Koalicioni qeverisës nuk e ka shumicën në Kuvend për tema më të thjeshta e lërë më për temat e interesit kombëtar. Vullneti i LDK-së është që ne të arrijmë një konsensus për këto tema, pastaj ta rishikojmë çështjen e legjitimitetit të institucioneve të Republikës së Kosovës", ka thënë Veliu, duke shtuar se LDK-ja do ta mbështesë Qeverinë për tema të mëdha. "LDK-ja është e gatshme, nëse arrijmë marrëveshje, për të krijuar një shumicë për tema të mëdha, jo për tema të ditës. Pra, për temat e mëdha që janë me interes kombëtar LDK-ja është e gatshme ta japë kontributin e saj, por sigurisht për ta dhënë këtë kontribut dhe për ta mbështetur qeverinë, ne duhet t'i dimë edhe afatet kohore", ka thënë Veliu.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kryeministër i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se konsensusi kombëtar për disa tema është i detyrueshëm për Kosovën. "Ne si AAK nuk kemi pasur një platformë të përgatitur për shkak se ka një platformë të institucioneve, edhe të Qeverisë. Ne mendojmë se kontributin deputetët mund ta japin edhe në Kuvend", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se për zgjedhje të reja tani nuk është i interesuar askush.

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate të Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se ka vullnet prej subjekteve për konsensus kombëtar. Në këto takime Limaj ka thënë se duhet të listohen se cilat janë temat me interes kombëtar, më pas, në takimet e ardhshme, të diskutohet hollësisht vetëm për një temë. Sa i përket platformës së dialogut, ai ka thënë se për këtë platformë dhe për udhëheqësin e bisedimeve me Serbinë duhet të vendosë Kuvendi. Sipas tij, Nisma Socialdemokrate do ta përkrahë çfarëdo vendimi që do të merret nga Kuvendi i Kosovës.

Ndërsa Ilir Deda nga Alternativa ka vlerësuar se nëse opozita dhe pozita bashkëpunojnë për tema të caktuara nuk do të thotë se janë në bashkëqeverisje. Ai ka thënë se duhet të punohet për gjetjen e konsensusit. Edhe sekretari i AKR-së, Vesel Makolli, ka bërë thirrje për konsensus kombëtar për temat që e presin vendin. Në këtë tryezë nuk kanë marrë pjesë Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe. Tryeza e radhës pritet të organizohet nga Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa tryeza e parë ishte organizuar nga LDK-ja.




## KMShK-ja kundërshton iniciativën rreth hartimit të Ligjit për media

Prishtinë, 8 maj - Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) ka shprehur shqetësimin dhe kundërshtimin për iniciativën rreth hartimit të Ligjit për media, duke e konsideruar përpjekje për kontroll dhe censurë mbi mediat. "Legjislacioni aktual në Kosovë rregullon në mënyrë të plotë funksionimin e mediave dhe KMShK-ja konsideron se nuk ka nevojë për ndonjë ligj të ri, si ai që po synohet të hartohet. Bordi i KMShK-së vlerëson se për mirëfunksionimin e mediave mjafton të zbatohen ligjet aktuale që përbëjnë praktikat pozitive të funksionimit të mediave. Bordi i KMShK-së e konsideron të papranueshme çdo përpjekje për ta kufizuar lirinë e mediave dhe të shprehjes nëpërmjet ligjeve të panevojshme", është thënë në deklaratën e Bordit të Këshillit të KMShK-së.

Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Flet për "Epokën e re", Dhurata Hoxha

# Integrimi në BE, rruga e vetme

**Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se integrimi i plotë në Bashkimin Evropian është rruga e vetme e shtetit të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ajo ka deklaruar se institucionet janë duke punuar maksimalisht që Kosova të jetë sa më afër familjes evropiane. Ministrja Hoxha ka bërë me dije se pret vlerësim pozitiv nga Brukseli, duke shprehur optimizëm se brenda këtij viti qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në vendet e Evropës. Ajo ka thënë se procesi integrues euroatlantik ka qenë dhe mbetet prioritet kombëtar i Republikës së Kosovës. Ministrja Hoxha ka vlerësuar se çështjet që kanë të bëjnë me procesin integrues deri më tani kanë dëshmuar unitet të lartë në Qeveri, në Kuvend si dhe në nivelet e tjera të institucioneve qendrore e lokale**



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 MAJ - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të martën se Kosova ka qenë, është dhe mbetet pjesë e pandashme e vlerave evropiane. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e Ditës së Evropës, ajo ka deklaruar se procesi integrues euroatlantik është prioritet kombëtar i shtetit tonë. "Aktivitetet për Ditën e Evropës dërgojnë një mesazh te opinioni vendor e ndërkombëtar, se prioriteti ynë kombëtar është procesi integrues euroatlantik dhe se kjo është rruga jonë e vetme, dje, sot, nesër. Kështu, këto tri ditë e bëjmë të qartë se kemi qenë, jemi dhe mbesim pjesë e pandashme e vlerave evropiane", është shprehur ajo, duke shtuar se institucionet janë duke punuar për ta ofruar Kosovën me Bashkimin Evropian.

Megjithatë, Hoxha ka thënë se vendimi final varet nga vendet evropiane dhe vullneti i tyre. "Ne po punojmë maksimalisht që Kosova të jetë sa më afër familjes evropiane. Kemi rezultate, të arritura dhe suksese. Fillimisht synojmë ta arrijmë liberalizimin e vizave, ndërsa zbatimi i mëtejmë i rekomandimeve, si zbatimi i MSA-së, përmbyllja e Agjendës Evropiane të Reformave dhe reformat ekonomike, do të sjellin nivelin e ri të marrëdhënieve tona me BE-në, lehtësimin e proceseve që çon në integrimin e vendit tonë në BE", ka theksuar ajo.

Ministrja Hoxha ka bërë me dije se pret vlerësim pozitiv nga Brukseli, duke shprehur optimizëm se brenda këtij viti qytetarët do të lëvizin pa viza në Evropë. "Ky komision faktmbledhës është i rëndësishëm për vlerësimin e të arriturave tona në fushën e sundimit të ligjit, luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ne sigurisht se kemi ndërmarrë të gjitha veprimet që të përmbushet kjo kërkesë, andaj presim nga Brukseli vlerësim pozitiv. Prandaj, presim që liberalizimi i vizave të bëhet këtë vit", ka deklaruar ajo. Hoxha ka vlerësuar se çështjet që kanë të bëjnë me procesin integrues deri më tani kanë dëshmuar unitet të lartë në Qeveri, në Kuvend si dhe në nivelet e tjera të institucioneve qendrore e lokale.

**"Epoka e re":** *Znj. Hoxha, ministria që ju drejtoni, me rastin e Ditës së Evropës, për tri ditë rresht do të organizojë disa aktivitete. Çfarë aktivitetesh do të jenë këto dhe cili është qëllimi i tyre?*

Hoxha: Aktivitetet për Ditën e Evropës dërgojnë një mesazh te opinioni vendor e ndërkombëtar, se prioriteti ynë kombëtar është procesi integrues euroatlantik dhe se kjo është rruga jonë e vetme dje, sot dhe nesër. Aspektet simbolike e përcjellin këtë agjendë treditore. E kemi filluar nga Universiteti 'Isa Boletini' në Mitrovicë, ku kam bashkëbiseduar me studentët për programet e arsimimit superior, në veçanti për programin Erasmus +. Kemi vijuar me ekspozitën e grave ndërmarrëse, të cilat me duart e tyre të arta sjellin frymën jo vetëm të ndërmarrësisë së grave, por edhe të vlerave të punëdoreve të tyre. Këtu veçoj gratë e minatorëve dhe Qendrën për të Drejtat e Grave, si dy ilustrime të grave tona, të cilat sjellin edhe pasurinë tonë nga tradita. Dita e parë vijon me koncertin e shkollave të mesme të muzikës të vendit tonë ku në spikamë vihet talenti i këtyre të rinjve që në mënyrën më të mirë prezantojnë dijen, pasionin dhe vlerat bashkëkohore muzikore. Pastaj kemi zhvilluar bashkëbisedimin me studentë në Bibliotekën Kombëtare për të vijuar me shpërblimet për nxënësit dhe gazetarët me temën e procesit integrues. Kështu, këto tri ditë e bëjmë të qartë se kemi qenë, jemi dhe mbesim pjesë e pandashme e vlerave evropiane.

**"Epoka e re":** *Sa është afër Kosova në proceset integruese që të jetë pjesë e familjes evropiane?*

**Hoxha:** Ne po punojmë maksimalisht që Kosova të jetë sa më afër familjes evropiane. Kemi rezultate, të arritura dhe suksese. Fillimisht synojmë ta arrijmë liberalizimin e vizave, ndërsa zbatimi i mëtejmë i rekomandimeve, si zbatimi i MSA-së, përmbyllja e Agjendës Evropiane të Reformave dhe reformat ekonomike, do të sjellin nivelin e ri të marrëdhënieve tona me BE-në, lehtësimin e proceseve që çon në integrimin e vendit tonë në BE. Ne sigurisht jemi përgjegjësit kryesorë në këto procese, por edhe një pjesë e përgjegjësisë varen nga faktorët e jashtëm, nga vendet anëtare të BE-së dhe vullneti i tyre.

**"Epoka e re":** *Këto ditë ka qëndruar në Kosovë një delegacion i Komisionit faktmbledhës të Bashkimit Evropian (BE) për vizat. Cili ishte mesazhi i tij për punën e institucioneve për plotësimin e kritereve për liberalizimin e vizave dhe kur pritet të jepet rekomandimi për vizat?*

**Hoxha:** Ky komision faktmbledhës është i rëndësishëm për

# e Kosovës



vlerësimin e të arriturave tona në fushën e sundimit të ligjit, luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ne sigurisht se kemi ndërmarrë të gjitha veprimet që të përmbushet kjo kërkesë, andaj presim nga Brukseli vlerësim pozitiv. Reforma e kërkuar dhe krijimi i kushteve për ngritjen e efikasitetit të gjyqësorit është pjesa jonë e punës si kabinet qeveritar, ndërsa puna e gjyqësorit është e pavarur dhe ne aty nuk mund të ndikojmë, sepse një nga vlerat e BE-së është pavarësia e gjyqësorit. Prandaj, presim vlerësim pozitiv si dhe presim që liberalizimi i vizave të bëhet këtë vit.

**"Epoka e re":** *Cili është koordinimi i pozitës me opozitën për zbatimin e reformave nga agjenda evropiane?*
**Hoxha:** Komisionet parlamentare përbëhen nga pozita dhe opozita, që merret me vlerësimin e procesit dhe shtyrjen e këtij procesi brenda kompetencave të veta. Vlerësoj lart këtë bashkëpunim dhe evidentim të çështjes së reformave si prioritet nacional, procesin integrues dhe veprimeve që çojnë përpara këtë proces. Konsideroj se procesi integrues i bashkon të gjithë, pa dallim, pozitë dhe opozitë, parti parlamentare e joparlamentare. Konsideroj se çështjet që kanë të bëjnë me procesin integrues kanë dëshmuar unitetin më të lartë jo vetëm në Qeveri, por edhe në Kuvend si dhe në nivelet e tjera të institucioneve qendrore e lokale.

**"Epoka e re":** *Ministre, para kabinetit qeveritar keni prezantuar rekomandimet kryesore të Raportit për Kosovën të Komisionit Evropian, duke adresuar çështjet dhe nga duhet vepruar intensivisht për të arritur progres që të njëjtat mos të përsëriten në raportin e radhës. Dihet se një numër i madh i rekomandimeve do të adresohet përmes zbatimit të Programit për MSA dhe Agjendës Evropiane të Reformave. Sa do të mund të plotësohen këto rekomandime nga ministritë të cilat janë pjesë e këtyre rekomandimeve?*
**Hoxha:** Jemi duke bashkëpunuar ngushtë me baza të rregullta të raportimit, duke shtyrë përpara agjendën e rekomandimeve, duke e vënë si prioritet kombëtar këtë proces. Rekomandimet janë të përballueshme për t'u zbatuar, por gjithsesi dinamizimi duhet shtuar, duhet aftësuar një sërë mekanizmash që japin rezultate të dëshirueshme për MSA-në, por edhe reformat e tjera. Përkushtimi ynë është i fuqishëm dhe nuk kemi rast tjetër për ta dëshmuar vendosmërinë tonë për procesin integrues. Konsideroj se rekomandimet janë marrë shumë seriozisht nga të gjithë faktorët relevantë institucionalë, andaj besoj fort se do të kemi sukses, sepse duam të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane dhe vlerave të saj. Ne kemi qenë, jemi dhe do të mbesim pjesë e vlerave euroatlantike. Këtë e di secili qytetar, këtë e do secili qytetar, gjithsesi edhe çdo nivel i institucionit, andaj nuk kemi çfarë presim, përpos t'i zbatojmë rekomandimet dhe t'i shtyjmë përpara proceset që na bëjnë pjesë të këtyre vlerave.

# Themelohet Komisioni për hartimin e Projektligjit për Qeverinë

"Qeveria është kjo që është. Unë mendoj se është funksionale, po i kryen punët e veta, mirëpo si qeveri e vendit dhe si vend që po aspirojmë të bëhemi anëtar i BE-së, Ligji për Qeverinë është i nevojshëm, i cili do ta definonte numrin e resorëve, numrin e ministrive, numrin e gjithë përgjegjësve, përfshirë zëvendëskryeministrat dhe zëvendësministrat.

**Prishtinë, 8 maj (ER)** - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen mbajtur të martën, ka marrë vendim për themelimin e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Qeverinë. Duke e vlerësuar të rëndësishëm miratimin e këtij projektligji, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se me këtë vendim dërgohet një porosi e mirë te BE-ja, se gjendja e Qeverisë dhe mënyra e ndërtimit të saj nuk është eksperiment pa kufi. "Qeveria është kjo që është. Unë mendoj se është funksionale, po i kryen punët e veta, mirëpo si qeveri e vendit dhe si vend që po aspirojmë të bëhemi anëtar i BE-së, Ligji për Qeverinë është i nevojshëm, i cili do ta definonte numrin e resorëve, numrin e ministrive, numrin e gjithë përgjegjësve, përfshirë zëvendëskryeministrat dhe zëvendësministrat. Ky është një proces i cili i takon Qeverisë ta bëjë. Unë e di se një pjesë e punës është bërë në të kaluarën", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se në një moment të duhur Qeveria do ta kalojë këtë ligj në Kuvend.
Në përputhje me përfundimet e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Qeveria të martën ka dhënë mendimin për Projektligjin për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Sipas Qeverisë, kjo nismë legjislativi do t'i kontribuonte zhvillimit dhe ruajtjes së vlerave tona historike në vazhdimësi.
Mendimit të Qeverisë i janë bashkangjitur edhe opinionet e zëvendëskryeministrit Fatmir Limaj, të cilat rekomandohet të merren parasysh gjatë diskutimit të tij në Kuvend. Gjithashtu, i është bashkangjitur edhe vlerësimi i ndikimit financiar dhe përputhshmëria e projektligjit me legjislacionin evropian.
Po në këtë mbledhje të Qeverisë është marrë vendim për rivarrimin e dëshmorëve të UÇK-së të Zonës Operative të Drenicës në varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Marinë të Komunës së Skenderajt. Me kërkesë të vet kryeministrit Haradinaj, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të ofrojë përkrahje logjistike, koordinuese dhe me kapacitetet e saj gjatë tërë procesit.



# Qeveria ua ndan nga 10 mijë euro familjeve të dy policëve, Dashi dhe Trena

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka marrë vendim t'ua ndajë 20 mijë euro familjeve të policëve Armend Trena dhe Malsor Dashi, të cilët kanë humbur jetën ditë më parë në një aksident në magjistralen Hani i Elezit - Kaçanik, me ç'rast kanë rënë në lumin Lepenc. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se dy familjeve do t'u ndahen nga 10 mijë euro nga kategoria e shpenzimeve rezervë. "Propozoj të ndahen nga 10 mijë euro për secilën familje për zyrtarët e rënë. Këto mjete propozohen të ndahen nga kategoria e shpenzimeve të rezervës", ka deklaruar Haradinaj.

# ASK-ja dhe Universiteti i Prishtinës arrijnë marrëveshje për bashkëpunim

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ku parashihet bashkëpunim i ndërsjellë ndërmjet dy institucioneve të Republikës së Kosovës. Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit është bërë nga rektori i Universitetit të Prishtinës, Marjan Dema dhe kryeshefi ekzekutiv i ASK-së, Isa Krasniqi. Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Krasniqi ka theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi ndërmjet ASK-së si institucion bartës i prodhimit të statistikave zyrtare dhe Universitetit të Prishtinës si institucion akademik për hulumtime shkencore, analiza e projeksione të ndryshme. "Kjo marrëveshje e mirëkuptimit ka për qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe ASK-së, që do të rezultonte në zhvillimin e politikave, zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve me interes të përbashkët. Po ashtu, do t'i shërbejë personelit akademik në mundësinë e qasjes në të dhëna të ndryshme statistikore për t'i realizuar aktivitetet e tyre hulumtuese dhe shkencore", ka thënë Krasniqi.

Kurse rektori i Universitetit të Prishtinës, Marjan Dema, ka folur për vlerën e informacionit në të gjitha fushat. Ai ka thënë se pikërisht është statistika ajo që i mbledh të gjitha ato informacione. "Ajo që na intereson neve është se jemi të interesuar ta japim kontributin tonë në ndryshime pozitive jo vetëm në Universitetin e Prishtinës, por edhe në komunitet. Planin strategjik e kemi ndërtuar në atë mënyrë që Universiteti i Prishtinës të jetë i orientuar nga një universitet kryesisht teorik, në një universitet të orientuar kah biznesi, puna dhe industria", ka thënë Dema. Në këtë aspekt, ai ka përmendur kontributin e madh të dekanit të Fakultetit Ekonomik, But Dedaj, i cili, bashkë me kryeshefin ekzekutiv të ASK-së, ishte iniciatori kryesor për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit.



# Ahmeti: Kapacitet e institucioneve në kërkim dhe shpëtim duhet të zhvillohen




PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Njohësi i çështjeve të emergjencave, njëherësh bashkëthemelues i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), Tahir Ahmeti, ka reaguar në profilin e vet në "Facebook" ndaj disa mangësive të institucioneve të reagimit, ndaj situatave emergjente, në rastin tragjik të humbjes së jetës së dy pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në lumin Lepenc. "Rasti tragjik i humbjes së jetës së dy pjesëtarëve të Policisë së Kosovës vuri në pah disa mangësi në lidhje me gatishmërinë e institucioneve të reagimit ndaj situatave emergjente. Me gjithë respektin për angazhimin maksimal dhe sakrificën e bërë, në kushte dhe rrethana shumë të vështira, të të gjitha njësive të Kosovës për Kërkim Shpëtim, Policisë së Kosovës, FSK-së, Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, por edhe organizatave vullnetare dhe qytetarëve, vërehet nevoja për koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe ngritje të gatishmërisë së këtyre institucioneve. Kapacitetet e Kosovës për gatishmërinë e reagimit ndaj situatave emergjente, në këtë rast të Kërkim Shpëtimit, duhet të zhvillohen dhe operacionalizohen, duhet të ketë sa më shumë ushtrime dhe simulime të përbashkëta për Kërkim Shpëtim (me skenarë të ndryshëm) të këtyre institucioneve", ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se Qeveria duhet të investojë më shumë në trajnime dhe në pajisje për institucionet e vendit që kanë njësi profesionale të kërkim shpëtimit. "Resurset dhe kapacitetet specifike për incidentet e këtij lloji duhet të jenë maksimalisht të përgatitura. Duhet reagim i shpejtë, i saktë në kohë, profesional dhe efektiv i të gjithë të përfshirëve në këto lloje të situatave", ka thënë Ahmeti.

# Policia fillon patrullimet me skuterë

PRISHTINË, 8 MAJ - Policia e Kosovës (PK), me qëllim të ruajtjes së sigurisë publike dhe rritjes të sigurisë së përgjithshme në trafikun rrugor, ka filluar patrullimet me skuterë. Ky patrullim, i cili besohet se do të jetë më efikas, përveç aspektit parandalues, do të jetë më praktik edhe për arritjen për kohë më të shkurtër aty ku kërkohet intervenimi policor. "Policia e Kosovës në vazhdimësi me aktivitete të ndryshme parandaluese po operon me qëllim të uljes së aksidenteve në trafik në përgjithësi, me theks të veçantë të atyre me fatalitet. Njësia e Trafikut Rrugor e regjionit të Prishtinës që nga sot do ta fillojë implementimin e planit operativ 'Kontrolli i shtuar i komunikacionit', ku fokusimi kryesor do të jetë në parandalimin dhe kontrollin e tejkalimit të shpejtësisë, tejkalimi në vijën e plotë, si dhe kundërvajtje të tjera", është theksuar në njoftimin e policisë.

Policia apelon tek pjesëmarrësit në trafik t'i respektojnë rregullat e trafikut rrugor, të përshtatet shpejtësia e automjetit me kushtet e rrugës si dhe të respektohen pjesëmarrësit tjerë në trafik.



# Nunn: Miqësia ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së do të jetë e përhershme

Drejtuesi i delegacionit amerikan, përfaqësues edhe në Komitetin për Marrëdhënieve Ndërkombëtare nga Iowa State Capital, Zach Nunn, gjatë takimeve me përfaqësues të institucioneve në Prishtinë ka thënë se Iowa do të jetë partnere e përjetshme e Kosovës



EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në takimin me delegacionin amerikan nga Iowa, i cili është mbajtur të martën në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit, ka thënë se Kosova ka nevojë gjithmonë për përvojën dhe dashurinë amerikane. Ai ka thënë se miqësia midis Kosovës dhe ShBA-së do të jetë e përjetshme.
Në fjalën e tij para mbi 50 mysafirëve amerikanë, Veseli ka bërë një rezyme të dhjetë vjetëve të funksionimit të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. "Në këtë sallë, para 10 vjetësh, Kosova, shtëpia juaj e dytë, shpalli pavarësinë. Historia që e sjellë 17 shkurtin e vitit 2008 është plot dhimbje e lavdi. Janë më shumë se 100 vjet përpjekje e brezave, për liri dhe pavarësi. Një ideal që nuk u shua nga asgjë. Por, kjo epokë i takon së kaluarës, asaj që mbetet kujtim dhe frymëzim për ne. Shteti i Kosovës tash është realitet", ka theksuar kryeparlamentari Veseli.
Ai ka shtuar se Kosova këtë vit ka mbushur një dekadë pavarësi dhe dy dekada liri, periudhë kjo gjatë së cilës shteti ynë ka bërë hapa gjigantë në konsolidimin e vet: ka ndërtuar institucione të qëndrueshme, ka ndërtuar nga e para këtë tokë, me rrugë nga më modernet në rajon, me qindra shkolla të reja, me një polici shembull, me një forcë ushtarake shumë profesionale, janë hapur fabrika dhe po ndërton gradualisht një shtet ligjor, ku secili qytetar është i barabartë.
Krejt këto dhe shumë të tjera, shtoi Veseli, nuk janë vetëm meritë e vendorëve, por kontribut i të gjithë miqve ndërkombëtarë. "Është kontribut i veçantë edhe i secilit prej jush që na keni ndihmuar për një arsim më cilësor, një ushtri më profesionale, për avancim të bujqësisë e të kulturës. Kosova ka nevojë gjithmonë për përvojën dhe dashurinë tuaj. Ne jemi shtete mike tash e 10 vjet, prej që Kosova është shtet dhe do të jemi për jetë e mot. Për ta ndihmuar njëri-tjetrin, për ta forcuar çdo vit e më shumë lidhjet tona. Zoti e bekoftë Amerikën, Iowan dhe Kosovën!", ka deklaruar kryeparlamentari Veseli.
Pas fjalës së kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, ka vazhduar takimi i delegacionit nga Iowa e ShBA-së me anëtarë të komisioneve të Kuvendit. Një nga drejtuesit e delegacionit amerikan, Zach Nunn, përfaqësues në Komitetin për Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Iowa State Capital, ka thënë se po fillon një kapitull i ri midis Kosovës dhe Iowas. Ai ka shtuar se qytetarët e Iowas në fushën e sigurisë kanë ndihmuar Kosovën në zgjidhjen e problemeve të saj.
Nunn ka shprehur dëshirën që bashkëpunimi mes Iowas dhe Kosovës të jetë i përhershëm. "Është mirë të shoh se sa keni përparuar. Ne dëshirojmë të jemi partneri juaj dhe pjesë e kapitullit tuaj të ri jo vetëm për 10 vjetët e ardhshëm, por për tërë jetën. Kosova ka bërë partneritet me ne, kemi edhe konsullatën tuaj atje. Kjo ka vendosur marrëdhënie edhe më të forta", ka theksuar Nunn.
Timothy Orr, gjeneral i Gardës Kombëtare të Iowas, ka pohuar se Kosova ka qenë pjesë e bashkëpunimit me Iowan edhe më përpara se të fillojë partneriteti në mars të vitit 2011. Ai ka shprehur kënaqësinë që ka pasur rastin të jetë në Kosovë që nga paslufta. Orr ka potencuar se për shtatë vjet të partneritetit dhe bashkëpunimit me FSK-në është ecur shumë përpara. "Zemra ime do t'i takoj çdoherë Kosovës. Kjo është shtëpia ime e dytë", ka deklaruar gjenerali Orr.
Në vazhdim të takimit, të cilin e drejtoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, fjalën e mori kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, i cili evokoi kujtime nga koha e luftës, përkatësisht masakra e Dubravës e vitit 1999. Ai ka thënë se tani po bëhen përpjekje për të ndërtuar dhe zhvilluar vendin, ndërsa mbështetja amerikane, veçanërisht e Iowas, sipas tij, është shumë e rëndësishme.
Hasani ka shtuar se nëse në luftë qëllimi ishte liria, tani synim kryesor i gjithë spektrit politik është zhvillimi i mëtejmë i shtetit dhe integrimi në strukturat euroatlantike.
Deputeti Dukagjin Gorani u tha mysafirëve amerikanë se kjo është shtëpia e tyre e dytë, ndërsa Kosova po përpiqet të bëhet model i së ardhmes.
Të pranishmëve me një fjalë rasti iu adresua edhe deputeti Ismet Beqiri, i cili theksoi përkushtimin për vazhdimin e ndërtimit të marrëdhënieve miqësore me ShBA-në. Ai ka thënë se historia e lidhjeve me Amerikën e bën bashkë gjithë spektrin politik të Kosovës.
Deputeti Milaim Zeka ka falënderuar në mënyrë të veçantë pilotët e NATO-s, duke i quajtur heronj të gjallë, të cilët më 1999 bombarduan sistemin e Milosheviqit.
Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi, ka theksuar se Kosova është një shtet i cili mbështet fuqishëm ShBA-në.

# Polici Armend Trena varroset me nderime të larta shtetërore



KAÇANIK, 8 MAJ - Pjesëtari i Policisë së Kosovës, Armend Trena, është varrosur të martën me nderime shtetërore në fshatin e lindjes, Begracë të Kaçanikut. Trupi i pajetë i policit Armend Trena u gjet të hënën në ujërat e lumit Lepenc, ku me veturën zyrtare, bashkë me kolegun e vet, Malsor Dashi, kishin rënë në mbrëmjen e 28 prillit.
Familjen, miqtë e kolegët e policit Armend Trena i ka ngushëlluar ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, përmes një telegrami. Në telegramin e ngushëllimit, ministri Gashi ka thënë se MBP-ja do ta kujtojë policin Armend Trena çdoherë si punëtor shembullor.
Ndërsa në një fjalë rasti, togeri Jaser Jaha nga Stacioni Policor i Kaçanikut ka thënë se ai dhe kolegët e tij ndihen të trishtuar nga dhimbja e shkaktuar nga vdekja e kolegut Armend Trena. Ai ka thënë se Armend Trena po i lë në kohën kur më së shumti i duhej familjes, shërbimit e atdheut.

# Formohet grupi punues për institucionet që nuk paguajnë tatim

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa është vendosur të formohet një grup punues dhe të shihen të metat e projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe për ato financiare jobankare



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 MAJ - Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të martën takim me drejtuesit e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Doganës dhe të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2018. Ky takim është përcjell me kritika të shumta ndaj Bankës Qendrore të Kosovës dhe Ministrisë së Financave sa i përket Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe për ato financiare jobankare.
Deputetët kanë kërkuar që institucionet mikrofinanciare që veprojnë si OJQ të mos veprojnë më në këtë mënyrë për shkak se që nga paslufta kanë përfituar miliona euro, gjithashtu japin kredi me norma të interesit deri në 31 për qind dhe nuk kontribuojnë në donacione, si dhe thellojnë edhe më shumë varfërinë.
Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, i ka quajtur OJQ-të institucione që veprojnë edhe me fajde. Po ashtu, ajo pati edhe kritika ndaj drejtorëve të këtyre institucioneve që paguhen nga 10 mijë euro deri në 20 mijë euro në muaj.
Deputetja Bajrami ka thënë se përfundimisht statusi i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve jobankare duhet të ndryshojë për këto institucione fitimprurëse që nuk i paguajnë tatim shtetit që 15 vjet.
Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se qëllimi i këtij projektligji është për një sistem stabil financiar. Ai ka deklaruar se BQK-ja adreson qartë kriteret për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. "Objektivat me këtë projektligj janë përshtatja e legjislacionit me atë të BE-së dhe vetëdijesimi i këtyre institucioneve për veprimtarinë e tyre. Për asnjë transformim nuk bëhet fjalë me këtë projektligj. Ky ligj i rregullon të gjitha institucionet mikrofinanciare që janë të regjistruara në MTI dhe nuk i rregullon ato mikrofinanciare si OJQ të regjistruara në MAP", ka thënë Mehmeti.
Kryetari i komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, ka thënë se për këtë çështje duhet të krijohet një grup punues dhe të shihen të metat e këtij projektligji që, sipas tij, janë të mëdha.

## Imeri: ATK-ja ka tejkaluar planin sa iu përket të hyrave

Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka raportuar të martën në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Në raportimin e tij para anëtarëve të këtij komisioni, Imeri ka thënë se ATK-ja ka tejkaluar planin e të hyrave si dhe mbledhjen e borxheve të paarkëtueshme. "Në këtë katërmujor kemi mbledhur 11 milionë euro më shumë apo 21 milionë euro më shumë sesa ka qenë e planifikuar në plan. Të hyrat nga TVSh-ja kanë qenë 47.5 për qind, nga të ardhurat e korporatave janë 23 për qind, si dhe nga të ardhurat personale 29.2 për qind. Ndërkaq, sa i përket rimbursimit të kuponëve fiskalë për këto vite, qytetarët e Kosovës kanë përfituar 28.7 milionë euro. Kurse nga borxhet e painkasuara në vitin 2017 që ishin 11 milionë euro, tani kemi inkasuar 16.8 milionë euro", ka thënë Imeri.
Edhe drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka raportuar para anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ai ka thënë se deri në fund të vitit Dogana pritet të ketë 70 milionë euro më pak të hyra. "TVSh-ja merr pjesë në importin e mallrave me 52 për qind. Vetëm veturat do të kenë efekt 40 milionë euro. Deri në fund të vitit pritet të ketë 70 milionë më pak të hyra", ka thënë Berisha. Ai ka thënë se të hyrat nga Dogana gjatë periudhës janar-mars 2018 arritën në total vlerën rreth 212 milionë euro.

# BERZh-i ndan 100 milionë euro për projekte të infrastrukturës lokale dhe të mjedisit

AMAN, 8 MAJ (ER) - Delegacioni i Kosovës, i kryesuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, është duke marrë pjesë në takimet vjetore të organizuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), të cilat po mbahen në Aman të Jordanisë. Gjatë këtyre takimeve ministri Hamza është pritur në takim të veçantë nga presidenti i BERZh-it, Suma Chakrabarti, për të diskutuar mbi bashkëpunimin financiar në mes të BERZh-it dhe Ministrisë së Financave, përkatësisht Qeverisë së Kosovës.
Ministri Hamza ka kërkuar që, përveç aktivitetit aktual, banka ta zgjerojë mbështetjen për sektorin privat, në veçanti për mbështetjen e bizneseve të reja që udhëhiqen nga të rinjtë dhe gratë. Gjithashtu, gjatë këtij takimi është nënshkruar edhe memorandumi i bashkëpunimit për Infrastrukturë Lokale dhe Mjedis, i cili parasheh bashkëpunimin afatshkurtër mes dy institucioneve për projekte në komunat e Kosovës, në vlerë totale deri në 100 milionë euro.
Memorandumi shërben si kërkesë fillestare për financim nga Ministria e Financave të Kosovës për projekte në sektorë kyçë të infrastrukturës lokale, siç janë ujërat dhe trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave të ngurta, ngrohja qendrore, transporti, infrastruktura rrugore dhe efiçienca e energjisë.
Nënshkrimi i këtij memorandumi rithekson zotimin e Ministrisë së Financave për të siguruar financim për projekte të nivelit lokal, të cilat janë të rëndësisë së veçantë për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës.
Ministri Bedri Hamza gjithashtu pritet të takojë edhe përfaqësues të tjerë të nivelit të lartë të Bankës për të diskutuar për progresin e projekteve aktuale dhe për mundësitë e financimit të projekteve potenciale për Kosovën.



# Kompani prestigjjioze marrin pjesë në Panairin 'Expokos'



Në Pallatin e Rinisë në Prishtinë është hapur të martën Panairi "Expokos 2018", dedikuar ndërtimit, energjetikës, teknologjisë dhe patundshmërive. Në këtë panair po marrin pjesë kompani prestigjioze nga Britania, Italia, Gjermania, Greqia dhe Turqia, si dhe një numër i madh i kompanive nga vendi. Panairi "Expokos" do të zgjasë deri më 8 maj

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 8 maj - Në Pallatin e Rinisë në Prishtinë është hapur të martën Panairi "Expokos 2018", i cili i dedikohet ndërtimit, energjetikës, teknologjisë dhe patundshmërive. Qëllimi kryesor i organizimit të përvitshëm të këtij panairi është gjetja e partnerëve të biznesit dhe klientëve të rinj si nga kompanitë vendore, po ashtu edhe nga ato ndërkombëtare. Pjesë e këtij edicioni të panairit janë kompani prestigjioze nga Britania, Italia, Gjermania, Greqia, Turqia, si dhe një numër i madh i kompanive nga vendi dhe shtetet e tjera të Ballkanit, të cilat për vizitorët e panairit do t'i prezantojnë risitë e fundit në fushat e tyre. Në këtë vit do të marrin pjesë edhe dhjetë kompani shqiptare-britanike të organizuara nga Oda Ekonomike Britanike. Me këtë rast, ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, ka thënë se ky panair ndihmon shtetin e Kosovës të krijojë ura të bashkëpunimit me ndërkombëtarë dhe të njihen më mirë produktet e vendit. "Në panaire të tillë me karakter ndërkombëtar mund të krijohen ura të bashkëpunimit që janë të rëndësishme për shtetin e Kosovës dhe si Qeveri e Kosovës ne po punojmë që t'i mundësojmë tregtisë së lirë të punojë sa më shumë që të largohen të gjitha barrierat tarifore dhe jotarifore në Kosovë", ka thënë Hasani, duke shtuar se në raportin që është publikuar nga Banka Botërore, Kosova ka qenë ndër 10 vendet që kanë bërë progres dhe reformim të shpejtë dhe kjo, sipas tij, tregon se ulja nga vendi i 60 në 40 ka bërë progres të mjaftueshëm në ambientin e të bërit biznes.

Kurse ministri i Infrastrukturës (MI), Pal Lekaj, ka thënë se pa ekonomi të vendit një shtet nuk mund të ekzistojë. Ai iu adresua bizneseve të pranishme, duke i vlerësuar lart për afarizmin e tyre. "Kosova po krijon ambient çdo ditë e më shumë për të investuar. Ne do të jemi në çdo vend për t'u zhvilluar një ekonomi familjare, sepse kështu ndihmojmë reciprokisht njëri-tjetrin", ka thënë Lekaj.

Drejtori i Odës Ekonomike Britanike në Kosovë, Bekim Kastrati, ka thënë se qeveria britanike ka potencial të madh t'i ndihmojë bizneset e Kosovës. "Dhoma e Ekonomisë Britanike shërben si platformë që të krijojë lidhje bashkëpunimi afariste në mes të Kosovës dhe Britanisë për të krijuar bashkëpunim dhe shkëmbime ekonomike në mes të këtyre dy vendeve", ka thënë Kastrati.

Kurse Bekim Xhafa nga organizata e panaireve CEO ka deklaruar se në edicionin e 17 të panairit, këtë vit për herë të parë ka përkrahjen britanike. Madje ai këtë panair e ka quajtur Porta e Ballkanit për faktin se në të po marrin pjesë rreth 50 kompani vendore dhe ndërkombëtare.




## Shkarkohet bordi i "Ibër Lepencit"

Prishtinë, 8 maj (ER) - Partnerët e koalicionit qeveritar janë përplasur të martën në mbledhjen e Qeverisë rreth vendimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE) për shkarkimin e bordit të drejtorëve të ndërmarrjes "Ibër Lepenci".

Ministri i MZhE-së, Valdrin Lluka, ka arsyetuar vendimin, duke thënë se, me gjithë kërkesën që të mos ketë ndarje të bonuseve, bordi i ka dhënë vetes bonuse, gjithashtu punëtorëve ua ka dhënë rrogën e 13. Lluka ka thënë se paga mesatare në këtë ndërmarrje është mbi 900 euro.

Kundër vendimit të shkarkimit të këtij bordi kanë qenë zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj dhe ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj. Megjithatë, kryeministri Ramush Haradinaj i ka dhënë përkrahje vendimit të ministrit Lluka.

# Përfundojnë punimet për rregullimin e platesë në Kalanë e Vushtrrisë

Vushtrri, 8 maj (ER) - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) më 7 maj ka përfunduar punimet për rregullimin e platesë në Kalanë e Vushtrrisë, pas degradimit si pasojë e nënshtrimit të vazhdueshëm në kushte jo të favorshme klimatike. Rivendosja e platesë dhe ekzekutimi i punimeve është bërë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) në koordinim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila e ka financuar këtë projekt.

Nivelizimi i konstruksionit të platesë, ndërrimi i dërrasave, mirëmbajtja dhe lyerja e konstruksionit metalik, largimi i vegjetacionit, konservimi dhe pastrimi i gurëve kanë qenë disa nga punët që janë realizuar për kthimin dhe rijetësimin e këtij monumenti të trashëgimisë sonë kulturore. IKMM-ja edhe më tej do të përkushtohet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin, si dhe për rijetësimin e monumenteve të trashëgimisë sonë kulturore.






# Inspektorët në Gjakovë marrin masa për lirimin e hapësirave publike

Gjakovë, 8 maj (ER) - Inspektorët komunalë në Gjakovë kanë vazhduar inspektimet për t'i liruar hapësirat publike, gjegjësisht largimin e produkteve ushqimore dhe joushqimore nga hapësirat publike në rrugën "Abedin Terbeshi".

Drejtoria për Punë Inspektuese edhe në ditët në vazhdim do t'i vazhdojë inspektimet e tilla me qëllim të përmirësimit të pamjes sa më të bukur të qytetit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit sa më racional të sipërfaqeve publike.

# Mbillen 12 drunj në kompleksin e dëshmorëve në 'Gradish'

Rahovec, 8 maj (ER) - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e "Javës së heronjve dhe dëshmorëve të Komunës së Rahovecit", kryetari i kësaj komune, Smajl Latifi, i shoqëruar edhe nga Ervin Hoxha, drejtor i DKRS-së dhe Vajdin Berisha, kryetar i OVLUÇK-së në Rahovec, kanë vizituar të martën kompleksin përkujtimor në vendin e quajtur "Gradish", i cili gjendet në mes të fshatrave Xërxë dhe Gexhe. Gjatë kësaj vizite kryetari Latifi dhe zyrtarët e tjerë që ishin në vizitë kanë mbjellë 12 drunjë dekorativë në këtë kompleks përkujtimor.

# Drejtues të Komunës së Mitrovicës inspektuan punimet në rrugën e Zasellës



Mitrovicë, 8 maj (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, i shoqëruar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Sami Zeka dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, Naser Muja, kanë inspektuar të martën punimet për asfaltimin e rrugës për në fshatin Zasellë si dhe kanë biseduar me qytetarët e fshatit edhe për problemet e tjera infrastrukturore dhe të fushave të tjera me të cilat po ballafaqohen banorët e atyshëm.

Po ashtu, ata kanë biseduar edhe me përfaqësuesit e kompanisë që ka fituar tenderin për asfaltimin e rrugës për respektimin e afateve për kryerjen e punëve sipas dinamikës së përcaktuar dhe me cilësi të lartë. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka dhënë sugjerimet e tij lidhur me çështjet e lartpërmendura si dhe ka premtuar mbështetje në rast se ajo kërkohet nga kompania punëkryese.

Përfaqësuesit e kompanisë përfituese "Rrukolli" u thanë zyrtarëve komunalë se punimet do të kryhen sipas dinamikës së paraparë dhe duke i respektuar të gjitha kriteret e marrëveshjes së nënshkruar.

# Komuna e Prishtinës rregullon varrezat e dëshmorëve në Siqevë

Prishtinë, 8 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se tashmë janë rregulluar varrezat e dëshmorëve në fshatin Siqevë. "Me angazhimin edhe të banorëve arritëm t'i rregullojmë varrezat e dëshmorëve të fshatit Siqevë, pak ditë para shënimit të përvjetorit të tyre", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



# Përse njerëzit vazhdojnë të jenë mohues të dijeve shkencore?



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Nuk do të zgjatem në fenomenin e sotëm përse njerëzit lexojnë kaq pak. Madje edhe kaq sa do të shkruaj ngurrova para dilemës hamletiane të shkruaj a të mos shkruaj, kjo është çështja. Më në fund fitoi të shkruarit! Në kohën tonë mund të shkruajnë shumë, në të shumtën me pagesë apo të shtyrë, ose të atillë që shkruajnë edhe me bark. Me këtë rast nuk e kam fjalën vetëm për biografitë e porositura, një dukuri krejtësisht në suaza të snobizmit paranik. Nuk dua të ndalem në këtë udhëkryq perversiteti edhe përmasash politike, por për këtë tjetër herë. Ka shumë për t'u thënë! Të vazhdoj... më pak janë ata që shkruajnë me bindje e akoma më pak ata që i arrijnë majat e dijeve shkencore, eruditen, intelektualen. Universalen! Këta e këto së bashku, çuditërisht duke qenë pakicë, zakonisht sulmohen nga shumica! Kjo, mbase, edhe pse nuk i kuptojnë. Natyrisht, kjo nuk vlen vetëm për ambientin tonë kulturor e arsimor. Mohuesit shfaqen kudo nëpër kohë e në hapësirë. Nuk janë specie vetëm e llojit tonë gjuhësor e vegjetues.

### Pse i shkrova gjithë këto fjalë, paksa edhe me indikacione të qarta?

Si shkas u bënë disa shkrime të këtyre ditëve të shkruara në rastin e 200-vjetorit të lindjes të njeriut, që në shumë fusha të dijeve shkencore e la vulën e fuqishme e ndikuese, që vështirë harrohet e madje-madje vështirë tejkalohet, siç ishte Karl Marksi. Marksi përveç majave që shkeli në shumë fusha, e sidomos në atë filozofike e ekonomike, ishte njeriu më me integritet dhe jo vetëm i epokës së tij. Vepra teorike e Marksit, në cilëndo fushë që ai kontribuoi, nuk mund të gjykohet me praktikën e sistemit socialist, që u vendos pas revolucionit të tetorit 1917, në BRSS, e më pas edhe pas Luftës së Dytë Botërore (1945 e tutje), ku qe aplikuar ai sistem apo edhe kudo ku sot ruhet emri i socializmit si sistem. Jo vetëm Marksi, por as edhe një teoricien, mendimtar, filozof a shkencëtar i cilitdo sistemi shoqëror nuk mund e as duhet të ngatërrohen nga praktikat e atyre sistemeve që zbatohen nga mashtrues e grabitës të ndryshëm. Madje, kjo vlen për të gjithë teoricienët e demokracisë që nga koha antike, amerikane apo evropiane e gjithë deri në ditët e sotme. Askund e nga askush në këtë botën tonë nëpër kohë e sisteme nuk ka përputhje të mendimtarëve, filozofëve apo shkencëtarëve të shkencave humanitare, juridike apo ekonomike me praktikat e qeverisjeve të ndryshme. Ose, për të qenë konkret, ta shpjegoj me një fakt të kohës sonë. A mund të formësojmë mendim e qëndrim të njëjtë me idealet e veprën sublime të Dëshmorëve të Kombit për liri e atdhetari me mënyrën e të qeverisurit pas pavarësisë, 17 shkurt 2008? Shkurt e shqip, të vlerësohet vepra sublime e të rënëve, siç ishte rasti i rënies së Jasharëve me njerëzit që qeverisin sot, është më shumë se marri. Të parët që u flijuan për idealet e lirisë, të pavarësisë së të demokracisë nuk e kanë as edhe një përgjegjësi për mënyrën sesi u qeveris e po qeveriset vendi ynë pas çlirimit, 12 qershor 1999.

E pra, vetëm njerëzit e padijshëm ose fanatikët e ideologjive të ndryshme mohojnë, kontestojnë apo selektojnë çka duhet lexuar e hequr nga leximi prej veprave të Marksit. Është interesante kjo qasje e "mendimtarëve" të sotshëm, e cila nuk bëhet për asnjë mendimtar tjetër, bile as për ata që në asnjë formë të vetme nuk mund të krahasohen me mendimtarin e nivelit vështirë të arritshëm, siç ishte filozofi e ekonomisti, Karl Marks.

Ka kohë që jam shkëputur nga leximi i veprës se Karl Marksit, se ambienti ynë është i tillë, larg, tepër larg nivelit intelektual të tij, por, gjithnjë, sa herë që kam lexuar pjesë nga vepra e tij, kam qenë mahnitur me nivelin e tij intelektual, nga opusi i dijeve të tij përmasash enciklopedike. Në këtë rast një falënderim të veçantë e meritojnë përkthyesit e atyre veprave për shqipërimin e mrekullueshëm të tyre. Pra, vepra e Marksit nuk ka nevojë të selektohet. Kushdo që do dije të nivelit të lartë intelektual, lexojeni se keni çka mësoni. Së paku bëheni njerëz me integritet e dinjitet, bëheni vetja. Por, Marksi nuk mund të lexohet e mbase as të kuptohet nga çdo nivel i arsimimit. Niveli ynë i arsimit lë shumë për të dëshiruar.

Mbase Marksi vazhdon të këtë nivel të lartë për çdo intelektual që ka prodhuar teknologjia e sotme informative! E të mos flasim që ne, shqiptarët e shkolluar, sot nuk e kemi as nivelin e të folurit e të shkruarit në dialektet e para viteve '70-ta. As edhe një komb nuk mund të prodhojë intelektualë e mendimtarë të mëdhenj, pa pasur frymëzim filozofët e mendimtarët e ndryshëm, qofshin edhe ata të para 2500 viteve.

Njerëzit nuk duhet të frikësohen nga mendjet e ndritura. Edhe kur mendjet e ndritura janë një pakicë. Në fakt, ata kurrë dhe askund nuk mund të jenë shumicë!

Në 19-vjetorin e rënies

# Dinë Grabovci, ai që dha gjithçka për lirinë e Kosovës

Lulëzim ETEMAJ

Para 19 vjetësh, më 8 maj 1999, kushërinjtë dhe bashkëfshatarët e mi, të Saradranit të Komunës së Istogut, me qëndresën dhe rënien e tyre, me gjakun e derdhur për liri, dëshmuan edhe një herë fuqishëm dashurinë e tyre për Kosovën, për të ardhmen e saj të lirë, të cilën po e jetojmë dhe gëzojmë ne sot.

Më 7 maj 1999, në ballafaqim me forcat serbe, në lagjen Nurçaj të fshatit fqinj, Kashicë, bien në altarin e lirisë luftëtarët e UÇK-së, Demush Mavraj, Luan Krasniqi dhe Hamdi Çetta. Në mesin e të rënëve të 8 majit gjendet edhe i shumëpërkushtuari, njeriu shembullor që, mbi çdo gjë, edhe mbi jetën e tij, e kishte vënë gjithmonë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, pjesëtari tjetër i UÇK-së, Dinë Grabovci, vëllai i të cilit, Adem Grabovci, ishte i burgosur politik tri herë radhazi, njëherësh ishte edhe një nga pesë nismëtarët e Aksionit të Pajtimit të Gjaqeve në vitin 1990 në Kosovë, më pastaj një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërkaq e bija e tij, në atë kohë studente, Luljeta, ishte një nga pjesëmarrëset më aktive në demonstratat e mbajtura në Pejë si dhe pjesëtaret e para të pajtimit të gjaqeve.

Në vitin 1990, kur Kosova ishte ngritur në këmbë më fuqishëm dhe me më vendosmëri se kurrënjëherë më parë në kërkim të të drejtave të shkelura dhe lirisë së mohuar nga ana e Beogradit zyrtar, shtëpia e Dinë Grabovcit në Pejë ishte shndërruar në njërën nga pikëtakimet më kryesore dhe njëherësh edhe më të sigurta të ish të burgosurve politikë të kësaj ane. Aty ato ditë hartoheshin planet dhe ndaheshin detyrat rreth organizimit të demonstratave në Pejë; aty kthehej natën vonë apo dhe mbas mesit të natës për ta shqyrtuar rrjedhën e demonstratës së ditës; për të ngrënë dhe për të bërë gjumë, ndërsa mikpritësi me zemër të madhe, Dinë Grabovci, si gjithnjë, krahas pjesëmarrjes së vazhdueshme gjatë ditës në radhët e para të demonstratave, për ç'gjë jo vetëm që ishte torturuar nga policia serbe dhe e kishte vënë jetën sa e sa herë në rrezik, përveç mirëseardhjes së dëshiruar nga zemra në çdo kohë, s'do të harronte asnjëherë, kur brenda ndodheshin ish të burgosur politikë, për të dalë përjashta dhe për të bërë roje. Për të bërë roje e organizuar roje. Roje jo me duar në xhepa, por duke qenë i armatosur. Dhe e bënte këtë fare natyrshëm. Krejt në heshtje. Sa që as pjesa dërmuese e të strehuarve, organizatorëve dhe pjesëmarrësve të demonstratave, nuk mund ta kishin diktuar këtë aktivitet të tij.




Duke besuar fuqishëm në rezultatet pozitive të tij dhe duke e konsideruar Aksionin për Pajtimin e Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave në Kosovë në vitin 1990, të cilin vendosëm për ta filluar në takimin që kishim mbajtur në odën e tij, me rëndësi të veçantë kombëtare, Dinë Grabovci, të cilin ish të burgosurit politikë dhe veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare në shenjë respekti meritor herë e quanin "Bacë" e herë "Baca Dinë", nga kursimet personale familjare kishte mbështetur që në nismë Aksionin me 1500 marka gjermane.

Si shumë të tjerë, që patën fatin ta përjetonin përkushtimin e tij ndaj lirisë së Kosovës, zemërbardhësinë dhe përkujdesjen e tij shembullore, edhe unë do ta ruaj me xhelozi përjetësisht kujtimin dhe respektin për patriotin e përkushtuar Dinë Grabovci.

Dhe, them se liria dhe pavarësia e Kosovës, shteti i Kosovës, do të mund të ishin një tregim i dëshiruar, një ëndërr e pa realizuar mbase edhe për gjenerate të tëra me radhë, po të mungonte kombëtarizma, gatishmëria dhe përkushtimi shembullor, përfshirë edhe sakrificën sublime, të tillë çfarë e kishin dëshmorët Dinë Grabovci, Demush Mavraj, Luan Krasniqi, Hamdi Çetta si dhe të gjithë të rënët tjerë, bashkëvendës të mi.



## Erdogani kritikon ashpër një grup personalitetesh franceze



ANKARA, 8 MAJ - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan reagoi me zemërim ndaj një grupi prej rreth 300 personalitetesh franceze, të cilët u kanë kërkuar myslimanëve të shquar t'i denoncojnë referencat anti-hebraike dhe anti-krishtere në Kuran. Duke folur të martën në një takim të partisë në pushtet, Erdogani i quajti "të neveritshme" personalitetet franceze në fjalë, ku bëjnë pjesë aktori Gerard Depardieu, këngëtari Charles Aznavour dhe ish-presidenti Nicolas Sarkozy, duke i akuzuar se kanë sulmuar shkrimet e konsideruara të shenjta nga myslimanët.
Deklarata e francezëve u bënte thirrje myslimanëve të denoncojnë disa referenca, në mënyrë që "besimtarët, - sipas tyre, - të mos i referohen një teksti të shenjtë për të kryer një krim". Presidenti Erdogan la të kuptohet se libra të tjerë të shenjtë kanë referenca të debatueshme. Nëse ata e kanë lexuar Biblën, tha ai, "ndoshta do të kërkonin që ajo të ndalohej".

# Trumpi tërheq ShBA-në nga marrëveshja bërthamore me Iranin

Mediet amerikane njoftojnë se presidenti Trump ka vendosur që ShBA-ja të largohet nga marrëveshja e deritanishme bërthamore me Iranin



UASHINGTON, 8 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump ka vendosur që ShBA-ja të largohet nga marrëveshja e deritanishme bërthamore me Iranin. Sipas medieve amerikane, këtë e ka deklaruar vetë presidenti Trump, ndërsa nuk kanë dhënë më tepër detaje rreth këtij vendimi.
Gjatë ditës së martë, në një njoftim në "Twitter", presidenti tha se do ta njoftojë vendimin e tij pas rreth dy orësh. Fillimisht ai kishte thënë se do ta njoftonte vendimin nëse do të hiqej dorë nga sanksionet amerikane ndaj sektorit të naftës dhe bankës qendrore të Iranit brenda ditës së shtunë, 12 majit. Këto masa, krahas me masat e tjera të vendosura nga Bashkimi Evropian dhe shtetet individuale, fillimisht u vendosën për të ushtruar presion ndaj Teheranit, që të hiqte dorë nga armët bërthamore.
Presidenti Trump po ashtu i dërgoi një mesazh ish-sekretarit të Shtetit, John Kerry, që ishte një prej negociuesve të marrëveshjes bërthamore me Iranin. Trumpi e akuzoi Kerryn se ka punuar prapa skenës për ta ruajtur marrëveshjen dhe la të kuptohet se një punë e tillë mund të jetë e paligjshme.
Kerry, komentoi të martën për këtë çështje nga Milano, ku ai ndodhet. Ai tha se disa udhëheqës botërorë të cilëve nuk ia përmendi emrin, po përpiqen të zhbëjnë traktate bërthamore të arritura në të kaluarën.
John Kerry tha se vërtet është sulmuar dhe njerëzit duhet të luftojnë për rikthimin e saj, përndryshe do të jetë e vështirë për të qeverisur. Ai tha "ne duhet të besojmë përsëri tek shkenca".
Irani ka këmbëngulur vazhdimisht se programi bërthamor ka synime paqësore dhe ra dakord për kufizimin e aktivitetit bërthamor në këmbim të sanksioneve që e kanë dëmtuar rëndë ekonominë iraniane.
Presidenti Trump e ka kritikuar marrëveshjen dha ka thënë se ajo është një marrëveshje e negociuar keq.

## Rusia dhe Irani, të shqetësuar për vendimin e Trumpit

Rusia dhe Irani shprehën shqetësime serioze për vendimin që mund të marrë presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, në lidhje me të ardhmen e marrëveshjes bërthamore midis Iranit dhe gjashtë fuqive botërore.
Kremlini paralajmëroi për një "situatë shumë serioze" nëse Trumpi tërheq ShBA-në nga marrëveshja.
Presidenti i Iranit, Hassan Rohani, pranoi se Republika Islamike mund të përballet me disa probleme nëse Trumpi rivendos sanksione kundër vendit të tij.
Me marrëveshjen e vitit 2015, Irani është dakorduar ta frenojë programin e tij bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare.
Trumpi është kritik i fuqishëm i kësaj marrëveshjeje. Sipas tij, Teherani është duke shkelur "frymën" e saj me hedhjen e vazhdueshme të raketave balistike dhe me mbështetjen e militantëve në rajon.

## Duma ruse e konfirmon Medvedevin për kryeministër



MOSKË, 8 MAJ - Duma shtetërore e Rusisë miratoi edhe një mandat të kryeministrit Dmitry Medvedev, një ditë pasi presidenti Vladimir Putin kërkoi që ai të vazhdojë në këtë pozitë.
Putini, i cili të hënën u betua për mandatin e katërt presidencial, e dorëzoi nominimin e tij në Dhomën e Ulët të Parlamentit, vetëm pak orë pas inaugurimit të tij formal.
Duma dominohet nga partia e Putinit "Rusia e Bashkuar" dhe Medvedev është udhëheqës i saj.
Me Kushtetutën e Rusisë, Qeveria është e detyruar të japë dorëheqje kur fillon mandati i ri presidencial.
Kryeministri është zyrtari numër dy në hierarkinë ruse. Ai mban përgjegjësi për ekonominë, ndërsa i përgjigjet presidentit.

## Udhëheqësi i opozitës armene merr postin e kryeministrit

JEREVAN, 8 MAJ - Parlamenti i Armenisë zgjodhi të martën kryeministër udhëheqësin e opozitës, Nikol Pashinian, në një votim me 59 vota për dhe 42 kundër.
Pashinian udhëhoqi protestat disajavëshe, kryesisht paqësore kundër korrupsionit dhe keqqeverisjes së ish-presidentit Serzh Sargsyan, pasi ai u zgjodh kryeministër. Kritikët e akuzuan Sargsyanin për manipulimin e kushtetutës së vendit, me qëllim që të vazhdonte të qëndronte në pushtet.
Dhjetëra mijëra armenë, mbështetës së kryeministrit të porsazgjedhur Pashinian, u mblodhën në sheshin qendror të kryeqytetit armen për ta festuar zgjedhjen e tij.
Partia Republikane, e cila ka shumicën në Parlament, më parë e pati bllokuar kandidaturën e Pashinianit për t'u bërë kryeministër. Kjo shkaktoi protesta të reja, atëherë partia republikane vendosi ta mbështeste Pashinianin e partisë së opozitës, siç u shprehën ata, për të mirën e vendit.



# Në përkujtim të nënëlokes së UÇK-së

Nga: Hysen DRESHAJ - Besniku

Personazh i esesë sime është Nole Osmanaj nga fshati Kaliçan i Istogut, e njohur si "Gjyshja" e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo kishte një emër, si të gjitha nënat, gjyshet e tjera por, që të gjithë Nole Osmanajn e thërrisnim "Gjyshe", madje jo vetëm gjatë luftës, por edhe pas saj. Gjyshe e thërriste i nipi i cili jetonte vetëm me të dhe gjyshe e thërrisnim edhe ne ushtarët që nga fillimi kur u njohëm me të.

Që nga fundi i vitit 1998 shtëpia e bacës Sokol ishte bërë një ndër bazat më kryesore në rajonin e Potgurit. I biri i tij, Eshrefi, ishte bërë krah i fortë i UÇK-së, ndërsa nëna e Sokolit, Nolja, priste dhe përcillte çlirimtarët sikur të ishin bijtë dhe bijat e saj. Familjen e tyre e kishte ndarë kurbeti dhe gjyshja Nole, e cila jetonte vetëm me të nipin Eshrefin, mallin që kishte për familjen e shuante me çlirimtarët, të cilët tanimë ishin bërë si një familje për të.

Gjyshja mbi supe mbante mbi shtatëdhjetë pranvera dhe ndihej e fortë dhe krenare, që edhe ajo mund të kontribuonte diçka për vendin e vet. Ajo bënte shumë: gatuante bukë për çlirimtarët, priste dhe përcillte ushtarë, ua lante rrobat!

Gjyshe Nolja tërë natën nuk flinte. Mjaftonte një trokitje e lehtë, shenjë dhe dera e pasme e oborrit hapej. Brenda na priste dhoma e ngrohtë dhe bujaria e Gjyshe Noles. Pastaj nuk vononte shumë dhe na kthente bukë. Ishte një malësore e vërtetë.

- "Hani bijtë e nënës, se jeni lodhur", na thoshte me ëmbëlsi gjyshja Nole.

- "Mos u mundo, oj gjyshe", i thoshim ne, sepse ndonjëherë ngushtoheshim për shkak të moshës së saj. E ajo na bënte të ndihemi të lirë, duke na uruar: - "Ju pastë, gjyshja, ju pastë, me ju po ndihem më e fortë".

Ajo kishte një zemër të madhe dhe ndihej shumë krenare me nipin e saj, Eshrefin, që i ishte bashkuar Ushtrisë çlirimtarëve, por edhe me bashkëluftëtarët e tij që tanimë ishin bërë pothuajse si pjesë e familjes së saj.

Na përcillte të gjithëve njëjtë, sikurse edhe nipin e saj, me fjalët: "Ju ruajt Zoti" dhe na priste me fjalët: "mirëserdhët bijtë e nënës" dhe i kthehej buzëqeshja kur na shihte që jemi të gjithë.

"Takohemi te gjyshja", ishte pika e kontaktit, e cila guxonte të jepej edhe përmes radiolidhjes, ngaqë vetëm pjesëtarë të UÇK-së e dinin kush është Gjyshja.

Aty takoheshin pjesëtarë të shumtë, qoftë nga Potguri, Rugova, Lugu i Drinit, Istogu etj., ndërsa Gjyshja lante rroba dhe gatuante bukë për të gjithë ne, edhe pse e shtyrë në moshë. Ajo shpeshherë gjente kohë dhe ulej me ne dhe me fjalët na trimëronte e na burrëronte, pasi që shumica ishim të rinj, por edhe dëshira e saj ishte të dëgjonte ngjarje për luftën, kurse sukseset e djemve dhe vashave të UÇK-së ia shtonin gëzimin dhe krenarinë. Por, shpesh tregonte edhe për ngjarjet, për tmerret dhe për vuajtjet që okupatori serb ua kishte shkaktuar familjarëve dhe të afërmve të saj.



Gjyshja Nole ishte një atdhetare e vërtetë dhe gjithmonë u besonte djemve të Ushtrisë Çlirimtare që do t'ia sjellin lirinë Kosovës. Madje edhe ajo me kontributin e vet ishte bërë pjesë e luftës, i dukej sikur po i shëron plagët dhe vuajtjet e së kaluarës.

Më 8 prill 1999, gjatë luftimeve në fshatin Jabllanicë, u plagosën numër i madh i ushtarëve të UÇK-së, në mesin e të cilëve edhe dëshmori Elez Berisha dhe nipi i saj, Eshrefi. Gjyshja Nole e përjetoi rëndë dhe i vizitoi të gjithë në Spitalin Ushtarak të improvizuar në Kaliçan. Të fundit e vizitoi nipin e vet, Eshrefin.

Të nesërmen nga plagët e rënda Elez Berisha ndërroi jetë. Në varrimin e tij prania e familjes ishte e pamundur për shkak të luftimeve, mirëpo tani ai kishte një familje të madhe: kishte shumë vëllezër dhe motra-bashkëluftëtarë të cilët e përcollën me nderime ushtarake. E fundit që ia ledhatoi flokët dhe e puthi në ballë, në vende të nënës, ishte Gjyshja Nole.

Ajo ishte e ndjeshme dhe i përjetonte rënd rëniet e luftëtarëve në fushëbeteja, sidomos rëniet e atyre që i kishte njohur për së afërmi, si: Elez Berisha, Selman Lajçi, Hajrush Elezi, Ismet Bicaj etj. Madje edhe pas luftës, deri në fundin e jetës së saj, ajo jetoi me kujtimin për ta.

Gjyshja Nole deri në fundin e jetës së saj jetoi e nderuar dhe e respektuar jo vetëm nga ata që i priti e i përcolli si bijtë e vet, por edhe nga të tjerët. Gjyshja e UÇK-së më 1 maj 2018 u nda nga kjo botë vetëm fizikisht sepse ajo me veprën e vet atdhetare dhe me kontributin e dhënë për çlirimin e Atdheut i krijoi vetes pavdekësinë. Ajo ishte një atdhetare e vërtetë, ishte një zonjë e vërtetë, ishte një trimëreshë dhe burrneshë e rrallë. Këtë e shprehën edhe bijtë dhe bijat e saj gjatë përcjelljes së fundit për në amshim. Gjyshe Nole dhe nënat e UÇK-së do të kujtohen me pietet gjatë historisë.

Në fund, le të jetë ky shkrim një mesazh për shkrimin e biografive edhe të nënave dhe nënëlokeve të tilla, pasi Kosova ka nëna të tilla shumë.

I përjetshëm qoftë kujtimi për Gjyshen e UÇK-së, Nole Osmanaj!

# Botohet në gjuhën angleze libri 'Kosova nga 'Naçertanie' deri te pavarësia (1844-2008)'

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Strategjia serbe ndër vite, për asgjësimin e shqiptarëve në Ballkan dhe qëndrimi dinjitoz i shqiptarëve kundrejt serbëve, vjen përmes librit të Jahja Llukës të botuar në gjuhën angleze "Kosovo from 'Naçertanie' to Independence" (1844-2008)".

Kjo është një vepër në formatin e një botimi akademik dhe universitar.

Vështrimi i ri teorik që sjellë autori Jahja Lluka është një risi në fushën e historisë së Kosovës, në atë të marrëdhënieve ndërkombëtare. "Autori vjen me fakte të reja në këtë botim, duke na pasqyruar në detaje situata dhe ngjarje të historisë së Kosovës, duke ilustruar gjithë strategjinë serbe ndër vite, për asgjësimin e shqiptarëve në Ballkan dhe na vendos përpara një panorame shumë dinjitoze të qëndrimit dhe mbijetesës shqiptare kundrejt hordhive serbe", thuhet në recensionin e prof. dr. Irna Peshkepia - Dobi.

Baza e konfliktit shqiptaro-serb qëndron në mitizimin e historisë së Serbisë, sipas së cilës, çdo territor ku ka kisha e manastire serbe, është dhe duhet të jetë territor i Serbisë. Shkak i këtij konflikti është gjithashtu miti nacionalist serb i viktimizimit, i cili prodhon deduksionin se "serbët fitojnë në luftë dhe humbasin kohë në paqe". Ky mit hipotetik nacionalist e ka zanafillën e ushqyerjes tek popullata serbe, hierarkia e Kishës Ortodokse të Serbisë të cilët e thelluan këtë konflikt për shekuj me radhë.

Irna Peshkepia-Dobi ka thënë se zhvillimet në Kosovë dhe konflikti i saj me Serbinë kanë qenë dhe mbeten prioritet i shumë studiuesve, por risia e këtij libri qëndron pikërisht në faktet dhe argumentet historiko-politike, ku marrëdhëniet dhe konfliktet ndëretnike vëzhgohen në këtë studim në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare.



E rrallë

## Vullkani Kilauea 'gëlltit' veturën në Hawaii



Vullkani Kilauea ka 'gëlltitur' një veturë në Hawaii për pak sekonda. Vullkani në Hawaii ka shpërthyer më 3 maj dhe ka shkatërruar deri tani 26 shtëpi. Të paktën 2000 persona janë evakuuar. Kilauea është një nga vullkanet më aktivë në botë.

FOTO E DITES




Një rrjedhë e vullkanit Kilauea lëviz në një rrugë në Hawaii. /USGS/

E jashtëzakonshme

## Vendoset rekordi botëror, në 1 minutë çan 51 shalqinj me kokë




Një burrë nga Pakistani ka çarë 51 shalqinj me kokë në përpjekje për ta thyer rekordin botëror të çuditshëm. Rashid Naseem nga Karaçi ka thyer rekordin e mbajtur nga Tafzi Ahmed i Gjermanisë, me 41 shalqinj të çarë për një një minutë. Rekordi botëror është regjistruar në Green Public High School në Pakistan.

## BARSOLETA E DITËS



**Gazetari: Axhë, a silleni mirë me gruan?**
**Axha: Valla bre axhë, kur t'i sjelli, në vend e la!**

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

### "BLACK PANTHER" 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler







Në ora 17:00

### "PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck

Në ora19:00

### "PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight







Në ora21:00

### "RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Sot jeni shumë emotiv si pasojë e të gjitha padrejtësive që keni pasur kohët e fundit. Do të shpërtheni dhe do të dëgjoheni shumë qartë nga të tjerët.



**DEMI** Jeni komplet të papërgatitur për disa situata të caktuara, kështu që mos merrni përsipër iniciativa që nuk mund t'i finalizoni dot.



**BINJAKËT** Indiferenca ndonjëherë është arma më e mirë për të mos u lënduar, sepse jeta na rezervon çaste jo gjithmonë të këndshme.



**GAFORRJA** Instinkti juaj po ju sugjeron të ndryshoni komplet drejtim nga ai që jeni duke përshkuar momentalisht. Një zgjidhje përfundimtare për një problem të madh.



**LUANI** Doni pranë vetes aleatë të fortë për të përballuar një projekt të madh. Sot do të vendosni duke qëndruar në qetësi dhe vetëm me veten.



**VIRGJËRESHA** Sot duhet t'u përgjigjeni shumë pyetjeve që kanë ngritur të tjerët karshi jush. Edhe pse kjo gjë ju bezdis, duhet t'i ndani njëherë e mirë gjërat.



**PESHORJA** Nëse sot do ta ruani autokontrollin do të dini se si të rregulloni disa gabime të së shkuarës që ju kanë dëmtuar shumë.



**AKREPI** Projektet personale ose profesionale duan kohën e tyre. Kohën tuaj nuk duhet ta cenoni aspak me situata artificiale.



**SHIGJETARI** Momentet e vogla që ju ofron dita duhet t'i merrni dhe t'i shfrytëzoni. Duke qëndruar pasiv nuk do të arrini askund.



**BRICJAPI** Edhe pse të heshtur, sot do të arrini ta dalloni qartë atë që ndodh në rrethin tuaj të ngushtë shoqëror. Mbase dhe ju duhet të pozicionoheni.



**UJORI** Mund të jeni vëzhgues të mirë, por kjo nuk do të thotë që mund ta ndryshoni rrjedhën e fakteve ose ngjarjet që verifikohen rreth jush.



**PESHQIT** Keni ide të bukura, por që është mirë t'i zhvilloni dhe të mos i lini thjesht në teori.

# Selena Gomez kritikohet për paraqitjen në "Met Gala"



Mbrëmja e "Met Gala" mblodhi shumë yje të famshëm në një nga ceremonitë më prestigjioze në botën e Hollywoodit. Shumë prej të pranishmëve rrëmbyen vëmendjen me paraqitjen e tyre, ndërsa pati edhe nga ata që këtë herë nuk ia qëlluan në veshje. Një ndër to ishte këngëtarja Selena Gomez, e cila u paraqit me një fustan të gjatë me material tyl me shkëlqim dhe nuk mori lëvdata nga adhuruesit dhe të pranishmit.





# Dua Lipa performon në ceremoninë hapëse të Ligës së Kampionëve

Dua Lipa është një ndër këngëtaret më të suksesshme shqiptare në rrafshin ndërkombëtar. Këngëtarja po vazhdon me sukses të mbajë koncerte të ndryshme anembanë globit dhe të sjellë këngë të reja muzikore. Pas shumë spekulimeve rreth një perfomance të mundshme në finalen e sivjetme të Ligës së Kampionëve, ka ardhur edhe reagimi i saj. "E ngazëllyer që do të bashkohem me Pepsin për të perfomuar në ceremoninë e hapjes së finales së Ligës së Kampionëve", ka shkruar 22-vjeçarja në rrjetin social "Instagram".

# Kirsten Dunstit i plotësohet dëshira, bëhet nënë për herë të parë



Kirsten Dunst dhe i fejuari Jesse Plemons janë bërë prindër të një djali. Aktorja 35-vjeçare për herë të parë është bërë nënë duke sjellë në jetë një djalë të shëndetshëm. "Aktorja amerikane Kirsten Dunst ka lindur në një klinikë private dhe ka sjellë në jetë një djalë të shëndetshëm. Lindja ka shkuar për mrekulli", ka thënë një burim për revistën "People".

# Qendra John F. Kennedy i revokon "Titullin e Nderit" aktorit Bill Cosbyt

Qendra John F. Kennedy për "Performing Arts" ka njoftuar se ka revokuar "Titullin e Nderit" që i kishte dhënë Bill Cosbyt, e cila ishte hera e parë që qendra kishte marrë një veprim të tillë. Njoftimi erdhi gati dy javë pasi që Cosby u shpall fajtor për tri akuza të sulmeve të pahijshme ndaj Andrea Constandit, një ish-punonjës i Tempullit.



Autor: Gazmend Morina - BENI

BENDI MUZIKOR NË FOTO 1

METAFORË E GJATË

NDESHJE NDËRMJET SKUADRAVE PËR TË FITUAR VEND-IN E PARË (sh.shq.)

BIMË QË PËR PËRDORET ORENDI

ZABURZENIA OBSESYJNO KOMPULSYËN

METODË STUDIMI / ISMET RAMUSHI

GRIMCË MOLEKULARE (sh.shq.)



DEPOJA

PËRPUNIM I HOLLËSISHËM I NJË PROJEKTI

KA A DEM I PATREDHUR / QË BESON NË SHUMË HYJNI

"LOKEREN" / NJËSI PESHE E BARABARTË ME NJË MIJË KILOGRAMË, TONI

FUTBOLLISTI AUSTRALIAN ... CAHILL

LLOJ LOJE FATI

OKSIGJEN, ZET, ELEKTRON / PARAGRAF

"IRLANDA"

MJESHTËRI, PROFESION / INSTITUCION PËR RUAJTJEN E OBJEKTEVE KULTURORE

AKTORJA HOLLIVUDIANE BASIGNER

LËRE (bised.) / HISTORIANI ROMAK LIVI

ZANORE

LLOJ KOSI ME HUDHRA

GJARPËR I MADH ME NGJYRË TË VERDHË

KËNGËTARJA BAJRAMI

REPER I NJOHUR AMERIKAN

MË MERREN MENDTË, E HUMB MENDJEN; HUTOHEM KREJT (bised.)

BASHKËTING-ËLLORE

SHTET (Fr.)

QË PRODHOHET NË SERI

NDERIM QË I BËHET MYSAFIRIT (arab.)

ASCOLI

QË SHEH VETËM DOBI-NË E ÇASTIT / PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE

GJENDJE E PAQËNDRUE-SHME EMOCIONALE (shq.) / ZANORE

EPOKA E RE

FABRIKA E MEKANIZUAR / QYTET NË SHQIPËRI

KRYEQYTETI I KAZAKISTANIT

VITI I RI KINEZ / BASHKËTING-ËLLORE

VEND I PAVARUR (sh.shq.)

REOMIR, TANTAL / DY BASHKË-TINGËLLORE

PLAKU ME PËRVOJË, QË MERREJ SI GJYQTAR NË NJË ÇËSHTJE / LIVORNO

KASTRIOT OSMANI

FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL ....

PJESË E KËMISHËS

BUJK / SKAJI, QOSHJA

LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS / KËNGËTARE & PREZANTUESE E JONA

TITAN, BOR / DJALI I DJALIT

KRAHINË E JONA

MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT / PËREMËR PRONOR

RAMADAN (perkdh.)

POSEDON DIÇKA / AKTORJA HOLLIVUDIANE ...... RYDER (shqip.)

KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)

TRAJNERI GJERMAN REHAGEL / UGANDA, JEMENI

REGJISORI I SHQUAR ...... STONE / KËNGËTARJA JONË ..... MIMANI

BASHKËTING-ËLLORE / ILAÇI

E PASUR, PASANIKE / RAVENA

EMËR YNI MASHKULLI (shq.) / SHKRIMTARI RAMADAN

ERA E MIRË

POETI MUSA ........

ISMET JASHARI

TRAJNERI HOLANDEZ ARI ... / BENDI MUZIKORE NË FOTO 2

VOZË E MADHE PËR VERË / SERA



NEVADA, ALASKA

LUFTËTARJA PALIKUQI / OPEN MOBILE ALLIANCE

SAHATI

VEÇIM

LIGJ, KANUN (vjet.) / FORTESAT

VARGJET E PËRPUTHURA / FUTBOLLISTI PATRICE .... (Manchester United)

THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI / RESHAT ARBANA

GODINA MBI LUMË / SPECIALIST LETTINGS AND MANAGEMENT

ADEM DEMAÇI / NUMËR THEMELOR

PËREMËR VETOR

EMAL / BESIM TE ZOTI

ZANORE / OTRANTO, ROMA

NANTES

GATESË E JONA / BASHKËTING-ËLLORE

FUTBOLLISTI ANGLEZ .... LENON / ZANORE

KIK-BOKSIERI MAKSUTAJ

AJRI I PASTËR MBI RETË (Poet.)

# GABRIEL GARCIA MARQUEZI TAKON ERNEST HEMINGWAYN

E njoha menjëherë teksa po kalonte me gruan Mary Welsh nëpër bulevardin "St. Michel" në Paris në një ditë pranvere me shi më 1957. Po ecte matanë rrugës, kah drejtimi i Kopshteve të Luksemburgut, veshur me një palë pantallona kaubojsh, një këmishë të trashë dhe një kapelë bejsbolli. E vetmja gjë që dukej se nuk i shkonte ishin syzet metalike, të vockla e rrethore, që krijonin përshtypjen e një njeriu të bërë gjysh para kohe. I kishte mbushur 59 vjet dhe kjo binte në sy. Nuk e linte përshtypjen e burrit të fuqishëm që, pa dyshim, se e dëshironte, sepse ishte i ngushtë në brez dhe këmbët i dukeshin rakitike mbi këpucët e rënda si të sharrëxhinjve. Dukej tip i gjallë midis këndeve të librave të dorës së dytë dhe rrëkesë rinore nga Sorbona, saqë as që mund të merrej me mend se i kishin mbetur vetëm edhe katër vjet jetë.

Për pak, qysh duket se më ndodhte gjithnjë, e pashë se isha ndarë në dysh ndërmjet dy roleve që po haheshin ndërmjet vete. Nuk e dija nëse ishte e udhës t'ia kërkoja një intervistë ose ta këpusja rrugën që t'ia shprehja adhurimin tim të dukshëm. Por çfarëdo që do të vendosja, tashmë po ndihesha njëjtë në siklet. Atëherë, flisja të njëjtën anglishte të çalë që e flas edhe tani, dhe nuk isha shumë i sigurt për spanjishten e tij toreadorçe. Dhe nuk e bëra asnjërën prej tyre meqë mund ta prishja atë çast, por në vend të kësaj lidha duart rreth gojës dhe, si Tarzani midis xhunglës, bërtita prej trotuarit të kësaj ane kah ana tjetër: "Maaaeeestro!" Ernest Hemingway e kuptoi se nuk mund të kishte tjetër mjeshtër në atë hallakamë studentësh, dhe u kthye, ngriti dorën, ma ktheu me spanjishten e Castilias me zërin krejtësisht fëmijëror: "Adiooos, amigo!" Ishte hera e parë dhe vetme që e pashë.

Atëherë isha gazetar, isha 28 vjeç, me një roman të botuar dhe një çmim letrar në Kolumbi, por isha në mëshirë të fatit dhe pa ndonjë cak në Paris. Kryemjeshtërit e mi ishin dy romancierët amerikanoveriorë, të cilët duket se nuk kishin asgjë të përbashkët. Kisha lexuar gjithçka që kishin botuar deri atëherë, por jo si lexim komplimentar - më parë do të thosha se ishte e kundërta, si dy forma reciprokisht ekskluzive dhe të shquara të koncpetimit të letërsisë. Një prej tyre ishte William Faulkner, të cilin kurrë nuk e kisha takuar dhe të cilin vetëm mund ta merrja me mend si bujk me mëngë të përvjela duke fërkuar krahun pranë dy qenve të tij të bardhë, në portretin e lavdëruar të Cartier-Bressonit. Tjetri ishte burri jetëshkurtër i cili, porsa më tha lamtumirë prej anës tjetër të rrugës, duke më lënë me përshtypjen se diçka kishte ndodhur në jetën time, dhe se nuk do ta harroja tërë jetën.

Nuk e di kush ka thënë se romancierët i lexojnë romanet e të tjerëve vetëm sa për të marrë vesh se si shkruajnë. Besoj se kjo është e vërtetë. Nuk jemi të kënaqur me sekretet e ekspozuara në faqet e veprave: e shfletojmë zhbirueshëm librin për të parë çfarë mbresa na lë. Në atë mënyrë që është e pamundshme të shpjegohet, e analizojmë librin fije e për pe, pastaj e përmbledhim që t'i kuptojmë misteret e mekanizmit personal të autorit. Orvatja është zemërthyese në veprat e Faulknerit, sepse duket se ai nuk ka ndonjë sistem organik të të shkruarit por, në vend të kësaj, shtegton qorrazi nëpër universin e tij biblik, si një tufë delesh që humbet në një dyqan plot kristale. Teksa mundohesh ta menaxhosh shkërmoqjen e një faqe të ngjashme, të krijohet përshtypja e frymëzimeve dhe hileve të zanatit, ajo ta humbë udhën nëse provoni të bëni bashkë ato fjali të së njëjtës faqe. Krejt ndryshe vepron Hemingway, i cili, me më pak pasion e shpirt, dhe me më pak çmenduri, por me ashpërsi plot shkëlqim, lë gjithçka hapur, si një makinë transporti mallrash. Mbase për këtë shkak Faulkneri është shkrimtar i cili ka shumë lidhje me shpirtin tim, por Hemingway është ai me të cilin lidhet më së shumti shkrimtaria ime - jo thjesht shkaku i veprave të tij, por i njohurisë së tij mahnitëse për zotësinë në shkencën e të shkruarit.

Në intervistën historike me George Plimtonin në "The Paris Review", (Hemingway) dëshmoi përgjithnjë, ndryshe prej nocionit romantik të kreativitetit, se rehatia ekonomike dhe shëndeti i mirë janë qenësore për të shkruarit; se një prej vështirësive më të mëdha është lidhja e fjalëve; se kur të shkruarit nis të bëhet punë e vështirë, atëherë duhet t'u kthehesh dhe t'i lexosh veprat e tua, me qëllim që të kujtosh se gjithnjë ka qenë punë e zorshme; dhe se nuk është e vërtetë se gazetaria e mbyt shkrimtarin, siç është thënë shpesh - më fort mund të thuhet lirisht se është e kundërta, kështu që kjo nuk përbën kurrfarë problemi. "Kur të shkruarit bëhet vesi më i madh dhe kënaqësia më e madhe", ka thënë ai, "vetëm vdekja mund t'i japë fund". Fundja, leksioni i tij ishte zbulimi se puna e përditshme mund të ndërpritet vetëm atëherë kur shkrimtari e di se ku do ta vazhdojë nesër. Unë nuk mendoj se ndonjëherë i është dhënë ndonjë këshillë më e dobishme për të shkruarit. As më pak e as më shumë, është ilaçi absolut për spektrin më të tmerrshëm të shkrimtarëve: agonia mëngjesore e përballjes me faqen e bardhë.

E gjithë vepra e Hemingwayt dëshmon se kjo frymë ishte brilante, por jetëshkurtër. Dhe është e kuptueshme. Një tension i brendshëm si ky, subjekt i një dominimi të tillë të ashpër të teknikës, nuk mund të ruhet brenda kuadrit të arritshëm të rrezikshëm dhe të pafund të një romani. Ishte natyra e tij, dhe gabimi i tij ishte orvatja që t'i zgjeronte kufijtë e tij të praruar. Dhe kjo është arsyeja pse gjithçka e tepërt është më e dukshme tek ai se te shkrimtarët e tjerë. Veprat e tij janë si tregime të shkurtra, që përtej proporcionales, përfshijnë shumëçka. Ndryshe, gjëja më e mirë e tregimeve të tij është se ta krijojnë përshtypjen se po mungon diçka, dhe pikërisht kjo është çfarë ngërthen misterin dhe bukurinë e tyre. Jorge Luis Borges, i cili është një prej shkrimtarëve më të mëdhenj të kohës sonë, i ka të njëjtat kufizime, por ka pasur nuhatjen që të mos përpiqej t'i kapërcente.



## GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ

Gabriel García Márquez (Gabriel Garsia Markez, i njohur edhe si Gabo, 6. 3. 1927 - 17. 4. 2014), ishte shkrimtar mjaft i njohur kolumbian. Lindi në Aracataca, një fshat i vogël pranë maleve të Karaibeve kolumbiane. Ndër vite veprat e tij janë shpërblyer me disa çmime, kurse në vitin 1982 iu dha edhe Çmimi Nobel për Letërsi. Në gjuhën shqipe Markezit i janë përkthyer dhe botuar mbi 20 libra nga botues dhe përkthyes të ndryshëm..

Gjuajtja e vetme e Francis Maconberit drejt luanit demonstron jashtëzakonisht shumë kur vjen puna e leksionit të gjuetisë, por edhe si përmbledhje e shkencës së të shkruarit. Në njërën prej tregimeve të tij, Hemingway shkruante se një dem nga liria, pasi fërkohej prapa gjoksit të matadorit, kthehej vrik si "një mace në kthesë". Besoj, me përulësinë më të madhe, se ky vrojtim është një prej atyre copëzave frymëzuese të çmendurisë që vijnë vetëm prej shkrimtarëve më madhështorë. Vepra e Hemingwayt është plot me prurje të tilla të thjeshta dhe verbuese, që shpalosin pikën në të cilën ai ka përshtatur përkufizimin e tij të shkrimit letrar: se, si një ajsberg është e rrënjosur thellë vetëm nëse mbështetet prej pjesës më të madhe të vëllimit të tij.

Ajo ndërgjegje teknike është pa dyshim arsyeja pse Hemingway nuk do ta prekë lavdinë me romanet e tij, por më fort me tregimet e shkurtra të disiplinuara. Duke folur për "Për kë bien kambanat", ai tha se nuk kishte ndonjë plan paraprak të thurjes së veprës por, mbase, e kishte krijuar përditë nga pak derisa po e zhvillonte veprën. Nuk kishte pse ta thoshte: Është e qartë kristal. Krejt ndryshe, tregimet e tij të shkurtra, përherë frymëzuese, janë imune ndaj çfarëdo sulmi. Si ato tria që i kishte shkruar një pasdite maji në një pension në Madrid, kur një stuhi dëbore e kishte detyruar të anulohej një luftë demash në festën e San Isidros. Ato tregime, siç i kishte thënë edhe vetë George Plimptonit, ishin "Vrasësit", "Dhjetë indianët" dhe "Sot është e premte" dhe që të tria janë magjike. Në të njëjtat linja, për shijen tim, tregimi në të cilën e hyjnishmja e tij që është shtypur më së shumti, ishte tregimi më i shkurtër, "Macja në shi".

Sidoqoftë, edhe nëse duket të jetë ngacmim i fatit të vet, mua më duket se vepra e tij më e magjishme dhe më humane është më pak e suksesshme: "Matanë lumit dhe në pemë". Është, siç ka thënë edhe vetë ai, diçka që kishte nisur si tregim dhe ishte zhvilluar duke humbur rrugën në një xhungël novele. Është e vështirë që të kuptohen kaq shumë çarje strukturore dhe kaq shumë gabime të mekanikës letrare në një teknikë të tillë të hollë - dhe në dialog aq artificial, madje edhe të komplotuar, te njëri prej farkëtarëve të rrallë të historisë së letrave. Kur vepra ishte botuar më 1950, kritika ishte treguar e ashpër por, gabimisht. Hemingway ndihej i lënduar kur dëgjoi shumicën e fjalëve dhe mbrojti veten nga Havana, duke dërguar një telegram të pasionuar që dukej i padinjitetshëm për një autor të namit të tij. Jo vetëm se ishte vepra e tij më e mirë, ishte edhe më personalja, të cilën e kishte shkruar në një agim vjeshte, me nostalgjinë e viteve të pakthyeshme tashmë të jetuara dhe të kohës së kthesës së madhe për vitet që i kishin mbetur.

Në asnjë prej librave nuk la shumë nga vetja, e as nuk kishte trasuar - me gjithë bukurinë dhe krejt brishtësinë e tij - një rrugë për t'i dhënë formë ndjenjës qenësore të krijimtarisë dhe jetës së tij: padobishmërinë e fitores. Vdekja e protagonistit të tij, kinse paqësisht dhe natyrshëm, ishte maskuar prej parashtrimit të vetëvrasjes.

Kur dikush jeton aq gjatë me veprën e një shkrimtari, madje me përjetim dhe ndjeshmëri të madhe, nuk i mbetet asnjë shtegdalje për ta ndarë fiksionin nga realiteti. Kam kaluar shumë orë për shumë ditë me radhë duke lexuar në po atë kafe në "St. Michel", që ai e konsideronte vend të mirë për të shkruar, sepse dukej i këndshëm, i ngrohtë, i pastër dhe miqësor, dhe gjithnjë shpresoja ta takoja edhe një herë vajzën që e kishte parë teksa po hynte në atë ditë të stuhishme, të ftohtë dhe të egër, atë vajzë të hijshme dhe rioshe, me flokët prerë pjerrtas mbi fytyrë, si një krah pëllumbi. "Ti je e imja dhe Parisi është i imi", shkruante ai për të, me atë forcën e parezistueshme të përvetësimit të penës së tij. Gjithçka që përshkruan, çdo çast që ishte i tiji, i përket përjetësisht atij. Unë nuk mund të kaloj pranë numrit 12, "Rue de l'Odeon", në Paris pa e parë atë duke folur me Sylvia Beachin, në një librari që tanimë nuk është e njëjta, ku e vriste kohën deri në gjashtë të mbrëmjes, edhe kur James Joyce mund t'i binte andejpari. Në stepat e Kenisë, me t'i vizituar, u bë pronari i demave dhe i luanëve të tij dhe i sekreteve më intime të gjuetisë. U bë i zoti i matadorëve dhe boksierëve, i artistëve dhe të armatosurve, të cilët ekzistuan vetëm për një çast derisa u bënë të tijtë. Italia, Spanja, Kuba - gjysma e botës - është e mbushur me vende që i përvetësoi vetëm duke i përmendur. Në Cojimar, një fshat i vogël afër Havanës, ku jetoi peshkatari i tij vetmitar i "Plakut dhe detit", ka një pllakate që kujton veprat e tij heroike, me një bust të praruar të Hemingwayt. Në Finca de la Vigia, në Kubën ku kishte gjetur prehje e ku jetoi deri pak para vdekjes, shtëpia mbetet e paprekur midis pemëve, me koleksionin e tij të shumëllojshëm të librave, trofetë e tij të gjuetisë, tavolina e punës, xhinglat e pafund të jetës nga e gjitha bota që ishin të tijat deri e mori vdekja dhe jetojnë edhe pa të, me frymën që ua dha me magjinë meritore të përvetësimit të tij.

Disa vjet më parë hyra në makinën e Fidel Castros, i cili është një lexues i regjur i letërsisë dhe, në ulëse, pashë një libër të vockël të mbështjellë me lëkurë të kuqe. "Është mjeshtri im Hemingway", më deklaroi Fidel Castro. Përnjëmend, Hemingway vazhdon të jetë aty ku më së paku pritet ta gjesh - 20 vjet pas vdekjes së tij - i përjetshëm, njëherësh fluturak, si atë mëngjes, mbase maji, kur më tha "Lamtumirë, amigo" matanë bulevardit "St. Michel".

*(Botuar më 26 korrik 1981 në gazetën "New York Times". Përktheu nga anglishtja: Rexhep Maloku. Marrë për botim në gazetë, nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | LEICESTER - ARSENAL | 2 | CHELSEA - HUDDERSFIELD | GG | HEARTS - HIBERNIAN | 3+ |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Besa bie nga Superliga, por zbulohet një yll futbolli

Liridon Balaj është ylli i ri i futbollit pejan që shkëlqen në fanellën e Besës, ani pse kjo e fundit ka befasuar të gjithë për të keq, duke rënë nga Vala Superliga. Balaj shumë shpejt mund të bëhet emër i madh në futbollin e Kosovës si Fisnik Papuqi e Fetim Kasapi, pse jo të bëjë karrierë edhe jashtë vendit sikurse Bernard Berisha dhe Fatos Beqiraj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 8 MAJ** - KF Besa ka tejkaluar për të keq parashikimet në këtë edicion, pasi për herë të parë në histori të vet ka rënë nga Superliga e Kosovës në futboll. Megjithatë, edicioni 20/17/2018 mund të mbahet mend gjatë në futbollin pejan, sepse është zbuluar edhe një yll i futbollit. Bëhet fjalë për Liridon Balajn, i cili fillimisht është ftuar në ekipin e parë nga trajneri Valdet Shoshi e në ndeshjet e fundit e ka fituar edhe vendin e titullarit.

Sikurse Balaj, paraqitje të mira në këtë kohë të "zezë" për Besën patën edhe disa lojtarë të tjerë të rinj që shumë shpejt pritet të shpërthejnë në futbollin e Kosovës. "Kam filluar të luaj futboll në moshën 10-vjeçare në akademinë e klubit të Besës, kurse tash më është dhënë rasti të luaj në ekipin e parë. Jam shumë i lumtur", ka thënë Balaj, i cili më pas ka treguar se për të ka qenë ëndërr stërvitja dhe zhvillimi i ndeshjeve me Fetim Kasapin, i cili është kapiten aktual i Besës dhe një nga lojtarët më të pëlqyer në Pejë prej përfundimit të luftës. "Karriera e Kasapit është mjaft e pasur dhe për mua ka qenë një ëndërr të punoj me të. E falënderoj shumë për mbështetjen e vazhdueshme që ma ka dhënë. Përveç Kasapit, një model i mirë për lojtarët në Pejë është edhe Haxhi Zeka, i cili ka dhënë shumë për futbollin e Kosovës", ka shtuar ai.



Futbollisti i ri nuk ka kontratë me Besën dhe në afatin kalimtar të verës mund të largohet, pasi ekipi pejan në edicionin e ardhshëm do të bëjë gara në Ligën e Parë. "Ende nuk kam vendosur por, me gjasë, do të largohem. Ta presim përfundimin edhe të dy xhirove të këtij kampionati, më pas do ta marr vendimin për të ardhmen", ka deklaruar ai.

Në fund, Liridon Balaj ka shprehur keqardhje që një klub me traditë të madhe siç është Besa të bjerë nga elita e futbollit. "Është mëkat i madh që Besa të bjerë në Ligën e Parë. Nuk është dashur të vijë puna deri këtu, pasi Besa është klubi më i madh në vend", ka përfunduar Balaj, i cili është pjesë edhe e Përfaqësueses U19.

# Kosova sot niset drejt Serbisë për Evropianin e Karatesë

**PRISHTINË, 8 MAJ** - Përfaqësuesja e Kosovës në Karate sot (e mërkurë) në orën 05:00 do të niset për në Serbi, ku do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian për Seniorë, i cili mbahet në Novi Sad të Serbisë nga data 9 deri më 13 maj. Përfaqësuesja e Kosovës në këtë kampionat do të paraqitet me 13 garues, ku prej tyre 11 në kategorinë individuale në disiplinën e katave dhe kumite. Në Kampionatin Evropian për seniorë janë paraqitur 52 shtete me gjithsejtë 532 garues dhe 622 paraqitje. Kosova në këtë kampionat përfaqësohet nga këta garues: Vlerona Shala dhe Argjend Berjani, Gresa Zhitia, Adelina Rama, Fortesa Orana, Diellza Dragusha, Ylli Cenaj, Alvin Karaqi, Herolind Nishevci, Orges Arifi, Elhami Shabani, Durim Haziri, Blodin Pakashtica.



# Finalja nis të shtunën



**PRISHTINË, 8 MAJ** - Seria e finales së madhe në IP Superligën e Kosovës në basketboll do të fillojë të shtunën me ndeshjen që do të luhet me fillim nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në kryeqytet ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Bashkimit. Sigal Prishtina në gjysmëfinale e ka eliminuar Golden Eagle Yllin me seri 3:0, ndërsa me të njëjtin rezultat edhe Bashkimi e ka eliminuar Rahovecin. Finalja do të luhet në sistemin një ndeshje në Prishtinë, një në Prizren, kurse bardhekaltrit e kanë epërsinë e terrenit vendës në rast se seria shkon deri në pesë ndeshje. Kampione e edicionit 2017/18 do të shpallet skuadra që arrin tri fitore. Duhet theksuar se kampion në fuqi është Sigal Prishtina, skuadër kjo që në këtë edicion e ka fituar Kupën e Kosovës duke e mundur në finale pikërisht Bashkimin.

## Limaj fton presidentin e Barçës ta vizitojë Kosovën

**PRISHTINË, 8 MAJ** - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, është takuar me presidentin e ekipit të futbollit të Barcelonës, Josep Mara Bartomeu, të cilin e ka falënderuar për mikpritjen. "Ishte kënaqësi që me ftesë të presidentit të klubit të futbollit Barcelona, Josep Maria Bartomeu, ta përcillnim bashkë ndeshjen në mes të gjigantëve të futbollit Barcelona dhe Real Madrid. Bartomeun e njoftova se Kosova ka plot talentë të rinj të futbollit të cilët kanë nevojë për përkrahjen dhe përvojën e klubeve si Barcelona", ka shkruar Limaj në profilin e vet në "Facebook". Ai ka treguar se e ka ftuar Bartomeun ta vizitojë Kosovën. "Me këtë rast e ftova presidentin z. Bartomeu që në një të ardhme të afërt ta vizitojë Kosovën për t'i parë mundësitë e mbështetjes që klubi i Barcelonës mund t'ua ofrojë talentëve të futbollit të Kosovës. Barcelona është një nga ekipet më me traditë në botë dhe asistenca profesionale që do të mund t'ua ofronte këtu talentëve, do të ishte jashtëzakonisht e madhe. Kosova është e bekuar që ka miq gjithandej botës", ka shkruar Limaj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstvoa - Ministry of Health
*Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division*

## SHPALLJA E REKRUTIMIT

| | |
|---|---|
| **Institucioni:** | Ministria e Shëndetësisë |
| **Departamenti:** | Divizioni për Komunikim Publik |
| **Titulli i vendit të punës:** | Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave |
| **Kategoria funksionale/Grada:** | Koeficienti - 7 |
| **Afati i kontratës:** | Nëpunës i karrierës – me kohë të pa caktuar |
| **Nr. i Referencës:** | MSh-14/05/18 |

**Detyrat kryesore:**

1. Menaxhon në mënyrë të përditshme ndërlidhjen e ministrisë me mediave të shkruara dhe elektronike si dhe gazetarët me të cilët punohet në baza të rregullta; 20%
2. Përcjellë shkrimet dhe publikimet e mediave lidhur me aktivitete dhe shërbimet e ministrinë dhe përgatit përgjigjet, reagimet sipas nevojës; 10%
3. Monitoron në vazhdimësi mediat e shkruara dhe elektronike dhe përgatit një përmbledhje të informatave për menaxhmentin e lartë të ministrisë; 15%
4. Mban dhe përditëson një bazë të dhënash të kontakteve të mediave dhe krijon marrëdhënie të mira me gazetarët kryesorë, veçanërisht të shëndetësisë;10%
5. Ndihmon mbikëqyrësin dhe Zyrtarin e Lartë për Komunikim me Publikun në përgatitjen e kumtesave, informatave, raporteve dhe publikimeve tjera për publikun; 15%
6. Pranon kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, evidenton kërkesat dhe i përcjell tek burimet përkatëse të cilët duhet të përgjigjen; 10%
7. Mirëmban, ruan dhe arkivon të gjitha kumtesat, informatat, raportet dhe publikimet tjera për publikun të ministrisë si dhe shkrimet e mediave të shkruara dhe elektronike për ministrinë;10%
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Shkollimi i kërkuar:** Diploma universitare, fakulteti i gazetarisë ose në ndonjë fushë të përafërt.

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Nëpunës i karrierës, pa afat të caktuar.

**Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: 09.05.2018 deri 23.05.2018**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren recepcion ose në faqen zyrtare të ministrisë, dhe dorëzohen në zyrën nr. 23 të Ministrisë së Shëndetësisë, Lagja Arbëria, rruga e Zagrebit p.n. (ish Spitali i mushkërive). Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund ti bëni në 038 212 -276.

***"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.***

***Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".***

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
*Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division*

## OGLAS ZA REGRUTACIJU

| | |
|---|---|
| **Institucija:** | Ministrstvo zdravstva |
| **Departman:** | Divizija za javne komunikacije |
| **Naziv radnog mesta:** | Zvaničnik za informisanje i praćenje medija |
| **Funkcionalna kategorija/Gradiranje:** | Koeficijenat - 7 |
| **Rok ugovora:** | Karijerni službenik – na neodređeno vreme |
| **Br. reference:** | MZ-14/05/18 |

**Glavni zadaci:**

1. Svakodnevno upravlja i povezuje ministarstvo sa štampanim i elektronskim medijima, kao i sa novinarima sa kojima radi na redovnoj osnovi; 20%
2. Prati pisanje medija i publikacija koje se odnose na aktivnosti i usluge ministarstva, priprema odgovore i reagovanja prema potrebi; 10%
3. Kontinuirano prati štampane i elektronske medije i priprema rezime informacija za viši menadžment ministarstva; 15%
4. Održava i ažurira bazu podataka o medijskim kontaktima i uspostavlja dobre odnose sa glavnim novinarima, posebno zdravstvenim novinarima,10%
5. Pomaže nadzorniku i višem zvaničniku za javnu komunikaciju u pripremi publikacija, informacija, izveštaja i drugih publikacija za javnost; 15%
6. Prima zahteve za pristup službenim dokumentima, vrši evidenciju zahteva i prosleđuje ih odgovarajućim izvorima koji trebaju dati odgovore; 10%
7. Održava, čuva i arhivira sva saopštenja za javnost, izveštaje i druge javne publikacije ministarstva, kao i publikacije u vezi ministarstva od strane drugih štampanih i elektronskih medija;10%
8. Obavlja i druge zadatke u skladu sa zakonima i propisima koje razložno i blagovremeno može zahtevati njegov nadzornik. 5%

**Uslovi učešća u regrutovanju:** Pravo aplikacije imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koji su završili adekvatno školovanje i koji imaju profesionalnu sposobnost u obavljanju poslova.

**Procedure konkurisanja:** Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate..

**Zahtevano školovanje:** Univerzitetska diploma novinarskog fakulteta ili sličnog smera.

**Sposobnosti / iskustvo i drugi zahtevani atributi:**

- Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poznavanje i iskustvo iz oblasti novinarstva i javne komunikacije;
- Sposobnost komunikacije, planiranja rada i rukovođenja ekipom;
- Sposobnost ispunjenja radnih zadataka pod pritiskom;
- Kompjuterske veštine za primenu aplikacionih programa (Word, Excel, Power Point, Interneta).

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje :** Na osnovu Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi na Kosovu kao i Uredbe br.02/2010 o proceduri regrutovanja u javnoj službi.

**Vremenski rok imenovanja:** Karijerni službenik, na neodređeno vreme .

**Datum publikacije i zatvaranja konkursa: 09.05.2018. do 23.05.2018.**

**Prijave aplikacija:** Aplikacije se mogu dobiti na recepciji ili preuzeti sa web stranice ministarstva i dostaviti u kancelariju br. 23 Ministarstva zdravstva na adresi: ulica "Zagrebačka" b.b.( bivša plućna bolnica). Na aplikaciji jasno navedite naziv radnog mesta i broj reference. Kontaktirati na telefon : 038 212 -276.

***"Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova, i prima aplikacije od osoba muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.***

***Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na proporcionalnu zastupljenost u civilnoj službi javne administracije,centralne i lokalne, kako je predviđeno u članu 11,stav 3 Zakona br.03-L-149 o civilnoj službi Republike Kosova".***

*Nekompletirane prijave i prijave nakon isteka roka neće se uzimati u obzir.*
*Zbog prevelikog broja primljenih prijava ,kontaktiraće se samo oni kandidati koji su izabrani u užem krugu.*

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Ref. Nr. 1041/18** **Pejë, 09.05.2018**

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurën Vlerësuese për Zgjedhjen dhe Avancimin e Personelit Akademik në UHZ, nr. 772, dt. 16.06.2014, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.05.2018, nxjerri vendim sipas të cilit:

**UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë**
**shpall**

## K O N K U R S

**për zgjedhjen e personelit akademik të rregullt**

**I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:**

**FAKULTETI I BIZNESIT:**

Një Mësimdhënës për lëndët: Taksat dhe Korporatat, Financa, Ndërmarrësi, Ekonomia Monetare, Bazat e Kontabilitetit.

Një Asistent për lëndët: Biznesi Ndërkombëtar, Mjedisi i Biznesit, Financat Ndërkombëtare, Ekonomia Rajonale e EU.

**FAKULTETI I MTHM:**

Një Mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Turizëm, Zhvillimi i Produktit në Turizëm dhe Hotelieri, Turizmi i Qëndrueshëm, Ekonomia e Turizmit dhe Biznesi.

**FAKULTETI JURIDIK:**

Një mësimdhënës për lëndët: Ekonomia, Financat dhe e Drejta Financiare, Institucionet Financiare Ndërkombëtare, Politika Ekonomike.

**FAKULTETI I AGROBIZNESIT:**

Një Asistent për lëndët: Biokimi, Fiziologjia e Bimëve, Gjenetika, Bioprodhimet.

Një Asistent për lëndët: Biologji, Ekologji e Përgjithshme, Mikrobiologji Ushqimore dhe Higjienë, Ekologji Bujqësore.

**II. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe Rregullores për Procedurën Vlerësuese për Zgjedhjen dhe Avancimin e Personelit Akademik Ref. Nr. 772 dt. 16.06.2014 në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet të kenë së paku gradën doktor të shkencave (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve) në fushën përkatëse, si dhe të plotësojnë kushtet tjera siç parashihen në nenin 171, 172 dhe 173, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
3. Kandidatët të cilët aplikojnë për asistentë duhet të kenë të përfunduar studimet master ose magjistraturë në fushën përkatëse me notë mestarë jo me pakë se 8 në të dy nivelet dhe të jenë jo më të vjetër se 28 vjet, të jenë të regjistruar në studimet e doktoratës më rastin e rizgjedhjes, më saktësisht shih nenin 174, të statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

**III. KUSHTET PËR APLIKIM:**

**IV.**

1. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjet e diplomave përkatëse të noterizuar, certifikatën e lindjes, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë; ndërsa, ata të cilët janë të punësuar në Fakultet duhet ta paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për asistentë duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjet e diplomave përkatëse të noterizuar, certifikatën e notave për nivelin bachelor dhe master, certifikatën e lindjes, si dhe vendimin për regjistrimin e studimeve të doktoratës më rastin e rizgjedhjes.
3. Kandidatet të cilët aplikojnë për me shumë se një pozitë duhet të sjellin kopje fizike për aq pozita sa aplikojnë.
4. Kandidatët të cilët dëshmojnë se njohin gjuhën angleze, frënge apo gjermane kanë përparësi si aplikues.
5. **Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar studimet master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi nga MASHT përkatësisht vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.**
6. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes në web-faqen zyrtare të Universitetit dhe gazetë, respektivisht deri më 23.05.2018.
7. Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive të nevojshme sipas konkursit, duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: apliko.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00-15:00. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë:

http://www.unhz.eu

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Protokol. Br. 1041/18** **Peć , 09.05.2018**

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, UA br. 07/2017 o regulisanju konkursne procedure u javnom sektoru, član 26. Zakona o visokom obrazovanju na Kosovu, br. 04 / L-037, člana 169, 170, 171, 172, 173, 174, statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, br. 04-V-622, uredbe o ličnom dohotku Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći br. Pro. 1944/16, dt. 05.10.2016, Pravilnika o postupku procjene za izbor i napredovanje akademskog osoblja UHZ, br. 772, dt. 16.06.2014, Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, na sjednici održanoj dana 07.05.2018, donio je odluku prema kojoj:

**UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" Peć**
**objavljuje**

## K O N K U R S

**za izbor redovnog akademskog osoblja**

**I. Konkurs se objavljuje na sledećim pozicijama:**
**FAKULTET BIZNESA:**
Nastavnik za predmete: Porezi i korporacije, Financije, Preduzetništvo, Monetarna ekonomija, Osnove računovodstva.

Asistent za predmete: International Business, poslovno okruženje, International Finance, EU regionalnog gospodarstva.

**FAKULTET MTHM:**
Nastavnik za predmete: Uvod u Turizmu, Razvoj proizvoda u turizmu i ugostiteljstvu, Održivi turizam, Ekonomija Turizam i biznis.

**PRAVNI FAKULTET :**
Nastavnik za predmete: Ekonomiju, Finansije i Finansijsko Pravo, Međunarodne finansijske institucije, Ekonomska politika.

**FAKULTET AGROBIZNISA:**
Asistent za predmete: Biokemiju, Fiziologiju bilja, Genetiku, Bioproizvodi.

Asistent za predmete: Biologija, Opšta Ekologija, Mikrobiologija i Higijena hrane, Poljoprivredna ekologija.

**II. OPŠTI USLOVI**

1. Izbor akademskog osoblja vrši se u skladu sa Zakonom br. 04 / L-037 o visokom obrazovanju u Republici Kosovo, u skladu sa dispozicijama Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, Pravilnika za Procedure vrednovanja o izboru i unapređivanje akademskog osoblja Pro. Br. 772 dt. 16.06.2014 na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći.
2. Kandidati koji apliciraju za nastavnika mora imati najmanje diplomu doktora nauka (Ekvivalent - Fakulteta likovnih umjetnosti) u odgovarajućoj oblasti i da ispunjavaju druge uslove kao što je navedeno u odjeljku 171,172 i 173, Univerziteta "Haxhi Zeka "u Peći.
3. Kandidati koji apliciraju za Asistenta moraju imati završen master studije ili magisterij iz određene oblasti sa prosječnom ocjenom ne manje od 8 u dva nivoa i da nisu stariji od 28 godina, da su upisani na doktorske studije u slučaju reizbora, tačnije na osnovu člana 174 Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći.

**III. USLOVI ZA APLICIRANJE**

1.Kandidati koji se prijavljuju za nastavnika moraju dostaviti sljedeće dokumente: zahtjev sa biografijom, ovjerene kopije relevantnih diploma, izvod rođenih, dokaz o naučnim i stručnim publikacijama, kao i druge dodatne specifične informacije, koje su važne za one koji se prijavljuju; dok oni koji su zaposleni na Fakultetu treba da dostave odluku o posljednjem izboru.
2. Kandidati koji se prijavljuju za asistenta moraju dostaviti sljedeće dokumente: zahtjev sa biografijom, ovjerene kopije relevantnih diploma,uvjerenje ocjena za bachelor i master nivo, izvod rođenih, kao i resenje o upisanim doktorskim studijama u slučaju reizbora.
3.Kandidati koji se prijavljuju za više od jedne pozicije moraju dostaviti fizicki toliko primjerak za svaku poziciju za koju aplicira.
4. Kandidati koji dokažu da znaju engleski, francuski ili njemački jezik imaju prednost kao aplikant.

**5. Kandidati koji imaju doktorat, magisterij ili koji su završili master u inostranstvu moraju također priložiti dokaze za provjeru relevantnih diplomu iz MONT-a, naprotiv odluku o nostrifikaciji određene diplome, u suprotno, dosje od podnosioca će se smatrati nepotpunim.**

6.Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na službenoj web- stranici Univerziteta i novinama, tačnije do 23.05.2018.
7. Ispunjene aplikacije zajedno sa kopijama potrebnih dokaza na osnovu konkursa , trebaju se poslati u elektronskoj formi na e-mail:apliko.online@unhz.eu a onda i predati u kancelariji protokola u Rektoratu od 09:00-15:00 h.
Aplikacije poslane posle roka kao i one nekompletne neće se razmatrati.

Konkurs možete pronaći objavljen i na web stranici na adresi:
http://www.unhz.eu

Republika e Kosovës
**Komuna e Malishevës**

**Drejtoria Për Arsim dhe Edukim**

*Nr: 11/340*

*Më:08.05.2018*

*Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ ( MPMS)Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:*

## KONKURS

*Për plotësimin e vendit të punës*

*Viti shkollor /2018*

| Nr. | Niveli, Shkolla | Pozita | Vendi i lirë/zëvendesim | Numri i pozitave | orë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHFMU" Imer Krasniqi" në Carrallukë | Mesimdhënës i programit fillor | Zëvendësim me kohë të caktuar deri sa të kthehët punëtorja prej pushimit të lehonisë | 1 | 20 |

**I.Aplikacionit i bashëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose çertifikatat), çertifikatat në vend të diplomes jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmit e përvojes në institucionet arsimore ( nëse ka)

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

**Kriteret e kualifikimit:** Fakulteti i Edukimit- Programi fillor, Fakulteti i Mësuesisë, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it Nr. 05/2015 dhe UA 06/2015

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmura me dokumente( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Përsonat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **08/05/2018 më datën:22/05/2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokolit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

---

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr.20, 10000 Prishtinë – KOSOVË
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

**Prishtinë, më: 08.05.2018**

**ODA EKONOMIKE E KOSOVËS, SHPALLË**

## KONKURS

**Pozita:** Një(1) Zyrtar për Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit (TPA), pranë Odës Ekonomike të Kosovës

**Përshkrimi i vendit të punëës**

- Asiston në hartimin e Rregullore të TPA-së;
- Asiston në hartimin vërtetime, kërkesa dhe shkresa tjera të administratës që lidhen me punën e TPA-së
- Asiston në seanca të TPA-së,
- Mbajtja e procesverbalete të sencave te TPA-së.
- Transkripton incizimet audiofonike të seancave;
- Si dhe punë tjera sipas rregullorës së TPA-së.
- Raporton të Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorit të Departamentit në baza javore.

**Kualifikimet që kërkohen:**

- Te ketë të kryer fakultetin Juridik
- Kualifikimet plotësuese profesionale, kanë përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze e preferuar.
- Të ofrojë dëshmi të punës profesionale
- Gatishmëri për punë ekipore, në stres dhe orar fleksibil,
- Të punojë i pavarur në përmbushjen e detyrave të dhëna.

Afati i dorëzimit të dokumentacioneve është deri më **17.05.2018.**

Dokumentacionin e nevojshëm për aplikim duhet të dërgohen tek znj. Fatmire Shala-Mjeku- Zyrtare e Lartë për Çështje Juridike të OEK-ut.
Adresa: Oda Ekonomike e Kosovës, Rr.Nënë Tereza nr. 20, 10000 Prishtinë.

EUROCHAMBRES | A member of ICC WORLD CHAMBERS FEDERATION | IRU International Road Transport Union | ISO 9001:2008

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou

**Kryetari i Komunës**
**Nr. 01-111/01-0028371-2/18 dt. 08.05.2018**
**Mitrovicë**

Në bazë të nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Komuna e Mitrovicës shpallë:

**NJOFTIM PËR PËRMIRËSIM TË KONKURSIT**

Në konkursin e shpallur me datë 08.05.2018 në gazetën "Epoka e Re" për pozitën: Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1 – BF/270 – 2 vende, është lëshuar një gabim teknik, ashtuqë në vend të numrit të Referencës: JP00033170 të vendoset numri i Referencës: JP00033129.

***

Na osnovu člana 81 Zakona o radu br. 03/L-212, člana 58 Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi i Zakonu o upravnom postupku, Opština Mitrovica objavljuje:

**OBAVEŠTENJE O KOREKCIJI OGLASA**

U konkursu objavljenom dana 08.05.2018 u dnevnom listu "EPOKA E RE" za poziciju: Zvaničnik za budžet i finansije 1 - BF / 270 - 2 položaja, iskrala se tehnička greška tako da umesto Referentnog broja JP00033170, postavlja se Referentni broj: JP00033129.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **"Sedturs"Sh.p.k** me seli në **Prizren** , ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër fiskal:**600927208**,dhe numër të biznesit :**70926970** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditorë nga data e shpalljes në gazetë.

---

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka**"Sedturs"Sh.p.k** u **Prizren** , doneo odluku da ugasi biznis po br.registra fiscal:**600927208**, br.registra biznis :**70926970**,I ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I protrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

---

ANNOUNCEMENT

All client are to be informed that the Company **"Sedturs"Sh.p.k** in Prizren hase come to the decision to quit its business with Fiscal Number : **600927208**,and bussines number :**70926970.** The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager –mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

" ZAP " sh.p.k. me NRB: 71078744 shpall:

NJOFTIM MBI SHUARJEN

Me këtë njoftim mbi shuarjen e shoqerisë me përgjegjesi te kufizuar "ZAP" SH.P.K. me seli ne Skenderaj rr.Rezistenca dhe pronar Zijadin Geci Sh , njoftojim te gjitha bizneset dhe personat fizik te cilet kan ndonje pretendim te mundeshem pë ndonje borgj apo te ngjajshme ne " ZAP " sh.p.k. te paraqesin pretendimet e mundeshme te argumentuara ne menyre qe ne tu pergjigjemi kerkesave te juaja.

Duke filluar nga dt. 08.05.2018 ky njoftim do te jete I publikuar ne gazeten ditore "Epoka e Re" dhe afati I pritshem per ndonje pretendim do te jete një muaj ditë.

Skenderaj 08.05.2018

Pronari

Zijadin Geci

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Arjeta Segaqa shpallë të pavlefshme diplomën e fakultetit të Filologjisë dega gjuhe shqipe.

▶ Erza Bajrami e lindur më 9 janar 2002 shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Xhemail Mustafa" në Prishtinë.

▶ Tefik Bulliqi shpallë të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

▶ Artan Cikaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Zenun Çoçaj" Gjonaj.

▶ Edin Nurce shpall te pavlefshme dëftesën vitit I SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Shpend Rada shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

▶ Shpend Rada shpall te pavlefshme dëftesat SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte